

VENDIM
Nr. 888, datë 17.12.2014

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 704, DATË 29.10.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE
PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM
TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE
DHE KOLAUDIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 704, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Miratimin e shtojcave të manualit të tarifave për shërbime në projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.”.

b) Rreshti i parë, i tabelës nr. 7, “Tabela shoqëruese e tarifave”, neni 29, paragrafi 1, Strukturat në ambientet e jashtme, e manualit të tarifave, miratuar me vendimin në fuqi, ndryshohet, si më poshtë vijon:

KOSTOT E LLOGARITSHME LEKË	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V	
	Nga	Deri	Nga	Deri	Nga	Deri	Nga	Deri	Nga	Deri
	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%
2,863,280	6.73	8.25	8.25	10.26	10.26	13.29	13.29	15.30	15.30	16.82

Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe të gjitha ministratë e institucionet që investojnë fonde publike në vepra ndërtimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MANUALI I TARIFAVE
PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE
DHE KOLAUDIM

(SHTOJCA)

AKRONIME

AKM -	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
ARM -	Agjencia Rajonale e Mjedisit
VNM -	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
PPV -	Plani i Përgjithshëm Vendor
PDV -	Plani i Detajuar Vendor
KKT -	Këshilli Kombëtar i Territorit
NJ.Q.V. -	Njësi të Qeverisjes Vendore

Shtojca 1.

Ref. Nenit 3, paragrafi 1: Shërbimet Shtesë

1.1 Shërbime që i takojnë studimeve të ndikimit në mjedis

1.1.1 Tipologjitë e studimeve të ndikimit në mjedis

1.1.1.1 Shërbimet bazë, që i takojnë studimeve të ndikimit në mjedis, për të vlerësuar gjendjen ekzistuese si pjesë e vlerësimit të ndikimit në mjedis, mund të përmbledhen nga shërbimet prej pikës 1 deri në pikën 5, të përcaktuara në paragrafin 1.1.1.2, në vijim.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza I	Vlerësimi fillestar mjedisor (Qartësimi i kërkesave të projektit dhe përcaktimi i qëllimit të tij)	3%
2	Faza II	Gjendja e mjedisit. (Identifikimi dhe vlerësimi i bazës së të dhënave, vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe përmbledhja)	30%
3	Faza III	Identifikimi i ndikimeve pozitive dhe negative (Analiza e konfliktit dhe alternativat)	20%
4	Faza IV	Plani i menaxhimit mjedisor (Versioni paraprak i studimit)	40%
5	Faza V	Raporti final (Versioni final i studimit)	7%

Tabela. 1 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për vlerësimet e ndikimit në mjedis

1.1.1.2 Tipologjitë mund të përfshijnë shërbimet, si më poshtë:

Shërbimet bazë

- 1) Vlerësimi fillestar mjedisor (Qartësimi i kërkesave të projektit dhe përcaktimi i qëllimit të tij)
 - Përshkrimi i zonës në studim.
 - Mbledhja e dokumentacionit planifikues, në dispozicion, specifikisht:
 - Studime dhe plane, vendore dhe rajonale;
 - Harta tematike, foto ajrore dhe të dhëna të tjera.
 - Përcaktimi i qëllimit të projektit dhe nevojën e shërbimeve të specializuara shtesë.
 - Inspektime në terren.
 - Identifikimi në parim i ndikimeve.

Orientimi i nivelit të VNM-së dhe konsultimi me AKM/ARM-në për vazhdimin e procedurave.

- 2) Gjendja e mjedisit (Identifikimi dhe vlerësimi i bazës së të dhënave, vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe përmbledhja):

- Përmbledhja e legjislacionit përkatës;
- Përcaktimi i gjendjes ekzistuese;
- Mbledhja e të dhënave mbi bazën e dokumentacionit ekzistues dhe mbikëqyrjeve lokale në terren, lidhur me:
- Marrëdhëniet e gjera ekologjike dhe veçanërisht ndikimet e faktorëve të peizazhit, si relievi, terreni, llojet e tokës dhe shkëmbinjve, sipërfaqet ujore, ujërat nëntokësorë, klima lokale, flora, fauna dhe habitati i tyre;

Shërbime të veçanta

- Analiza të veçanta mbi bazat mjedisore, mbi problemet socio-ekonomike.
- Paraqitja e një përmbledhjeje të situatës ekzistuese dhe vlerësimit të saj, duke përdorur edhe hartat.
- Shqyrtime të detajuara të burimeve natyrore, problemeve ekzistuese dhe çështjeve socio-ekonomike.
- Mbikëqyrje të detajuara në terren.
- Parashikime.

- Zonat e mbrojtura, peizazhet karakteristike dhe habitatet me vlera të mbrojtura;
- Përdorimet ekzistuese, dëmtimet dhe projektet e propozuara;
- Pamja dhe struktura e peizazhit;
- Asetet e materialeve dhe trashëgimia kulturore.
- Vlerësimi i situatës ekzistuese;
- Vlerësimi i qëndrueshmërisë dhe ndjeshmërisë së ekosistemit dhe peizazhit, në përputhje me parimet e konservimit të natyrës dhe menaxhimit të peizazhit.

3) Identifikimi i ndikimeve pozitive dhe negative
(Analiza e konfliktit dhe alternativat):

- Identifikimi i pasojave të projektit, si rrjedhojë e ndikimit të tij në mjedis.
- Lidhja e ndjeshmërisë ekologjike dhe ajo e përdorimit të zonës së studimit me ndikimin në mjedis të projektit dhe përshkrimi i efekteve reciproke të faktorëve më të rëndësishëm.
- Karakterizimi i ndikimeve negative, sipas fazave të projektit (Faza e ndërtimit, faza e shfrytëzimit dhe faza finale).
- Vlerësimi i peshës së tyre, efekteve, qëndrueshmërisë dhe mundësisë për t'i zvogëluar apo evituar mbi bazën e karakteristikave, vlerave dhe ndjeshmërisë së mjediseve të prekura.
- Paraqitja e përmbledhjes në formë narrative dhe në hartë.

- Përlogaritje të zgjerimeve.
- Mbajtja e evidencave/protokollove.
- Përditësimi bazës së të dhënave të planifikimit.
- Shqyrtimi i efekteve dytësore të qëllimit të studimit.

Identifikimi i ndikimeve kryesore që do të jenë objekt i masave evituese.

- Identifikimi i ndikimeve sociale.
- Përshkrim i ndikimeve të pa evitueshme.
- Krahasimi i alternativave.
- Analiza e zhvillimit të 2 ose 3 alternativave më të mira duke i krahasuar nga pikëpamja e vlerave dhe dëmtimeve/ pasojave mjedisore, sociale dhe ekonomike.

rzgjedhja e alternativës më të përshtatshme.

4) Plani i menaxhimit mjedisor (Versioni paraprak i studimit)

Zhvillimi i zgjidhjes bazë për elementët thelbësore të projektit dhe paraqitja e tyre në formë narrative dhe hartë së bashku me alternativat.

- Identifikimi, vlerësimi dhe paraqitja për çdo zgjidhje thelbësisht të ndryshme, duke patur parasysh vendimin për të shmangur ndikimet negative dhe/ose për të favorizuar ato pozitive ndaj ekosistemit.
 - Riskun ekologjik ndaj ekosistemit;
 - Dëmtimin e pamjes së peizazhit;
 - Ndikimin tek njerëzve, tek përdorimi i strukturave, tek të mirat materiale dhe tek trashëgimia kulturore.
- Përshkrimi i tendencave të zhvillimit në zonën e analizës, pa ndërhyrjen e projektit të planifikuar (parashikimi prognozës status quo).

Shërbime të veçanta

- Prodhimi i elementeve shtesë për prezantimin.
- Prezantimi i planeve, palëve të treta dhe institucioneve të specializuara.
- Përpunimi i planeve të detajuara në shkallë të veçantë.
- Konsultimi me publikun.

➤ Identifikimi dhe paraqitja e dëmtimeve, për të cilat është parashikuar që nuk mund të bëhen përmirësime. ➤ Seleksionimi krahasues për alternativat thelbësisht të ndryshme. ➤ Aprovimi i draftit paraprak të studimit nga klienti. 5) Raporti final (Versioni final i studimit) ➤ Prezantimi i studimit të ndikimit në mjedis në tekstin e përshkruar si dhe në një hartë përgjithësisht në shkallë 1:5 000, duke përfshirë një raport jo teknik.	
--	--

1.1.2 Grupet tarifore për shërbimet bazë, lidhur me studimet e ndikimit në mjedis

1.1.2.1 Tarifat fikse për shërbimet, lidhur me studimet e ndikimit në mjedis, janë përcaktuar, duke iu referuar kritereve në vijim:

i) Grupi I tarifor:

Studime të ndikimit në mjedis, në një shkallë të ulët vështirësie, specifikisht për një zonë në studim:

- Me një nivel të ulët të strukturave ekologjiksht të rëndësishme,
- Me një nivel të ulët ndryshueshmërie të peizazhit,
- Me një nivel të ulët të përdorimit rekreativ,
- Me një ndryshueshmëri të ulët të kufijve ose të kërkesave të përdorimit,
- Me një nivel të ulët të ndjeshmërisë së presioneve ndaj mjedisit dhe problemeve të ekosistemit dhe peizazhit,
- Projekteve dhe masave me nivel të ulët të intensitetit të mundshëm të dëmtimeve;

ii) Grupi II tarifor:

Studime të ndikimit në mjedis, me një shkallë vështirësie mesatare, specifikisht për një zonë në studim:

- Me një nivel mesatar të strukturave, ekologjiksht të rëndësishme,

- Me një nivel mesatar ndryshueshmërie të peizazhit,
- Me një nivel mesatar të përdorimit rekreativ,
- Me një ndryshueshmëri mesatare të kufijve ose të kërkesave të përdorimit,
- Me një nivel mesatar të ndjeshmërisë së presioneve ndaj mjedisit dhe problemeve të ekosistemit dhe peizazhit,
- Projekteve dhe masave, me nivel mesatar të intensitetit të mundshëm të dëmtimeve;

iii) Grupi III tarifor:

Studime të ndikimit në mjedis, me një shkallë vështirësie të lartë, specifikisht për një zonë në studim:

- Me një nivel të variueshëm dhe më të gjerë të strukturave ekologjikut të rëndësishme,
- Me një shkallë të lartë ndryshueshmërie të peizazhit,
- Me një përdorim rekreativ intensiv,
- Me një ndryshueshmëri të lartë të kufijve ose të kërkesave të përdorimit,
- Me një nivel të lartë të ndjeshmërisë së presioneve ndaj mjedisit dhe problemeve të ekosistemit dhe peizazhit,
- Projekteve dhe masave me nivel të lartë të intensitetit potencial të dëmtimeve.

1.1.2.2 Për rastet, kur studimet e ndikimit në mjedis kanë kritere, të cilat nuk përfshihen brenda të njëjtit grup tarifor dhe që bëhen shkas për pasiguri në përcaktimin e secilit grup tarifor do t'i përkojë studimi, atëherë do të ndiqet sistemi i përlogaritjes së pikëve, siç parashtrohet në paragrafin 1.1.2.3, në vijim dhe përcaktimi i grupit tarifor do të bëhet mbi bazën e shumës totale të pikëve të grumbulluara.

- i) Grupi I tarifor: Studime të ndikimit në mjedis deri 16 pikë;
- ii) Grupi II tarifor: Studime të ndikimit në mjedis me 17-30 pikë;
- iii) Grupi III tarifor: Studime të ndikimit në mjedis me 31-42 pikë.

1.1.2.3 Për të caktuar studimin e ndikimit në mjedis, në grupin tarifor të duhur, do të vendosen pikë, që reflektojnë shkallën e vështirësisë për kërkesat e mëposhtme:

- i) Niveli i strukturave me rëndësi ekologjike;
- ii) Pamja e peizazhit;
- iii) Përdorimi rekreativ;
- iv) Kërkesat për përdorim, sa i komplikuar është destinacioni (shkalla e vështirësisë për arkitektin);
- v) Ndjeshmëria ndaj presioneve mjedisore dhe problematikat e ekosistemit të peizazhit;
- vi) Projektet dhe masat, me një nivel të lartë të intensitetit potencial, të ndikimit në mjedis:

Për të caktuar grupin e saktë tarifor të studimeve të ndikimit në mjedis, bëhet vlerësimi si më poshtë:

Pika i), ii) iii) dhe iv) 0-6 pikë;

Pika v) dhe vi) 0-9 pikë.

1.1.2.4 Tarifat për shërbimet bazë, të listuara në pikën 1.1.1, në lidhje me studimet e ndikimit në mjedis, për zona më të mëdha se 50 ha, mund të bazohen në tabelën në vijim të tarifave, që përmban normën e tarifës minimale dhe maksimale, në përputhje me sipërfaqen totale të zonës në studim, në hektarë.

1.1.2.5 Vlerësimet e ndikimit në mjedis, sipas legjislacionit në fuqi, kryhen me procedurë paraprake dhe me procedurë të thelluar.

Tarifat, në tabelën në vijim, i referohen vetëm procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Për VNM të realizuara sipas procedurës paraprake, tarifa e shërbimit do të jetë sa 30% e vlerës së tarifës së përcaktuar në tabelë (për procedurën e thelluar).

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS						
SIPERFAQE NË HEKTARË	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III	
	Nga	Deri	Nga	Deri	Nga	Deri
	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
0.5	9,310	11,369	11,369	13,419	13,419	15,479
1	11,172	13,643	13,643	16,103	16,103	18,574
5	55,860	68,217	68,217	80,515	80,515	92,872
10	111,720	136,434	136,434	161,029	161,029	185,743
20	223,440	181,853	181,853	214,657	214,657	247,564
30	335,160	299,128	299,128	356,145	356,145	413,251
40	446,880	468,794	468,794	562,947	562,947	657,101
50	558,600	682,168	682,168	805,147	805,147	928,716
100	744,726	909,263	909,263	1,073,284	1,073,284	1,237,821
250	1,210,116	1,495,642	1,495,642	1,780,726	1,780,726	2,066,253
500	1,873,126	2,343,968	2,343,968	2,814,737	2,814,737	3,285,505
750	2,449,189	3,091,495	3,091,495	3,734,316	3,734,316	4,376,695
1000	2,978,463	3,788,179	3,788,179	4,597,968	4,597,968	5,407,684
1250	3,461,168	4,421,053	4,421,053	5,380,789	5,380,789	6,340,600
1500	3,909,168	5,026,000	5,026,000	6,142,905	6,142,905	7,259,737
1750	4,397,768	5,646,863	5,646,863	6,895,442	6,895,442	8,144,463
2000	4,839,947	6,205,095	6,205,095	7,570,168	7,570,168	8,935,242
2500	5,642,737	7,232,842	7,232,842	8,822,874	8,822,874	10,412,979
3000	6,422,242	8,167,305	8,167,305	9,912,442	9,912,442	11,657,505
3500	7,085,326	8,985,347	8,985,347	10,885,884	10,885,884	12,785,979
4000	7,725,126	9,741,642	9,741,642	11,758,600	11,758,600	13,775,116
4500	8,272,158	10,436,263	10,436,263	12,600,295	12,600,295	14,764,400
5000	8,842,326	11,130,368	11,130,368	13,418,779	13,418,779	15,706,821
5500	9,470,705	11,816,663	11,816,663	14,163,063	14,163,063	16,509,021
6000	10,052,074	12,472,232	12,472,232	14,892,021	14,892,021	17,312,179
6500	10,587,537	13,108,421	13,108,421	15,628,863	15,628,863	18,149,747
7000	11,076,063	13,728,768	13,728,768	16,381,474	16,381,474	19,034,105
7500	11,692,726	14,485,063	14,485,063	17,277,400	17,277,400	20,069,737
8000	12,286,179	15,202,379	15,202,379	18,118,653	18,118,653	21,034,926
8500	12,855,979	15,954,547	15,954,547	19,053,632	19,053,632	22,152,200
9000	13,403,011	16,683,947	16,683,947	19,964,884	19,964,884	23,245,821
9500	13,926,463	17,426,537	17,426,537	20,926,316	20,926,316	24,426,537
10000	14,426,632	18,149,747	18,149,747	21,872,863	21,872,863	25,595,905

Tabela. 2. Tabela shoqëruese e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

1.2 Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themele

1.2.1 Fusha e veprimit

1.2.1.1 Shërbimet, që lidhen me kapacitetin mbajtës të tokës, punime tokësore dhe themele, janë për të regjistruar reagimet midis strukturës së tokës dhe ndërtesave, si dhe mjedisin e saj, për të përcaktuar parametrat kryesorë të strukturës së tokës të nevojshme për llogaritje.

1.2.1.2 Shërbimet që lidhen me kapacitetin mbajtës të tokës, punime tokësore dhe themele, në mënyrë të veçantë mund të përfshijnë:

- Vlerësimi i nëntokës dhe puna konsultuese për pozicionimin e themelit, si një bazë për dimensionimin e tyre si mbajtës ngarkesash në strukturën inxhinierike, për aq sa këto shërbime nuk mund të kryhen me aplikimin e tabelave ose informacioneve të tjera, të përfshira në rregulloret e ndërtimit në fuqi;
- Mbikëqyrja dhe vlerësimi përgatitor për vendin e punës;
- Kryerja e analizave laboratorike dhe e testeve në terren;
- Këshillimi për sigurimin e strukturave ngjitur;
- Dhënia e zgjidhjeve, drenazhimi dhe llogaritje të tjera statike të tokës, ku shërbime të tilla nuk janë të përfshira, nga paragrafi 1.2.1.1 më lart, ose nga shërbimet e përcaktuara në Nenin 32 ose Nenin 39.
- Studimet që përfshijnë tensionet dinamike në llogaritjet e ndërtesave apo themeleve;
- Këshillimi mbi masat e ndërtimit në shtresat e ngurta shkëmbore;
- Miratimi dhe pranimi i gjurmëve dhe derdhjeve;
- Vlerësimi i përgjithshëm i kapacitetit mbajtës të strukturës së tokës dhe mundësitë për themele, që nuk lidhen me një ndërtesë të veçantë ose vepra inxhinierike.

1.2.2 Vlerësimi i nëntokës dhe konsulencat për punimet në themele

1.2.2.1 Vlerësimet e nëntokës dhe këshillimet e punës së themeleve, siç janë përcaktuar në paragrafin 1.2.1.2, pika 1, mund të përfshijnë shërbimet në respektim të ndërtesave dhe punëve inxhinierike.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse jepen në tabelën më poshtë:

Nr.	Shërbimet që i takojnë nëntokës dhe punimeve në themel	Përshkrimi	Përqindja e tarifës, në lidhje me vlerën totale
1	Faza I	1. Qartësimi i kërkesave të projektit; 2. Përcaktimi i strukturës së tokës nga dokumentet ekzistuese, duke specifikuar dhe prezantuar strukturën e nëntokës, sipas testeve të kërkuara.	15%
2	Faza II	1. Analizimi dhe prezantimi i rezultateve të testeve, laboratorike dhe në terren për strukturën e nëntokës; 2. Vlerësimi i gamës së lëkundjeve të tokës me përmbajtje uji; 3. Vlerësimi i nëntokës, specifikimi i parametrave kryesorë në strukturën e tokës.	35%
3	Faza III	1. Paraqitja e rekomandimeve për qëndrueshmërinë e themeleve dhe presionet e lejuara në tokë, në rast të veçantë propozohet dhe dimensionimi i themelit; 2. Deklaratë mbi çëdimet e pritura nga realizimi i veprës për të realizuar shërbimet bazë të përfshira në projektin final, siç paraqitet tek neni 39; 3. Udhëzimet për të gërmuar themelet dhe për të mbajtur edhe strukturën e thatë, edhe kontrollimin e ndikimit të projektit në strukturat ngjitur.	50%

Tabela. 3 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për nëntokën dhe punimet e themeleve.

1.2.2.2 Tarifat për shërbimet, siç tregohen në paragrafin 1.2.2.1 si më sipër, mund të përcaktohen duke iu referuar kostove të llogaritshme, grupit tarifor për të cilat janë caktuar themelet dhe tabelës së tarifave në pikën 1.2.3.3.

1.2.2.3 Kostot e llogaritshme mund të përcaktohen sipas Nenit 38.

1.2.2.4 Nëse komisioni nuk i mbulon të gjitha shërbimet e renditura në paragrafin 1.2.2.1., atëherë Neni 8 zbatohet në përputhje me rrethanat.

1.2.2.5 Tarifat për veprat e inxhinierisë, me gjatësi të madhe, (në objekte lineare, psh: salla të mëdha fabrikash) janë objekte negocimi.

1.2.2.6 Neni 11, paragrafi 1 deri në 3, të zbatohen në përputhje me rrethanat.

1.2.3 Grupet tarifore për shërbimet, lidhur me vlerësimin e nëntokës dhe konsulenca për punimet në themele

1.2.3.1. Grupet tarifore për vlerësimin e nëntokës dhe punës këshilluese për themelet mund të përcaktohet në bazë të kritereve të mëposhtme:

i) Grupi I tarifor:

Punimi i themeleve që përfshin një shkallë shumë të ulët vështirësie, në mënyrë specifike:

- Struktura që ndikohen shumë pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me një lloj themeli të vetëm, shtresimi i rregullt i nëntokës, aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi çedimi, brenda sipërfaqes së ndërtimit.

ii) Grupi II tarifor:

Punimi i themeleve, që përfshin një shkallë të ulët vështirësie në mënyrë specifike:

- Struktura, që ndikohen nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me lloje të ndryshme themeli apo tensione të lokalizuara, fuqimisht të ndryshme, shtresimi i rregullt i nëntokës, aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi çedimi, brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- Struktura që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me lloje të ndryshme themeli, apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, shtresimi i rregullt i nëntokës, aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- Struktura që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me një lloj të vetëm themeli, shtresimi i parregullt i nëntokës, aftësi të ndryshme mbajtëse dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

iii) Grupi III tarifor:

Punimi i themeleve që përfshin një shkallë mesatare vështirësie, në mënyrë specifike:

- Struktura, që ndikohen shumë nga çedimi, me mundësi për zgjidhje, shtresimi i rregullt i nëntokës dhe aftësi mbajtëse të njëtrajtshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;

- Struktura, që ndikohen nga çedimi, me mundësie për zgjidhje me tipe vendndodhesh të ndryshme të themelimit apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës, varion aftësia mbajtëse dhe mundësi çedimi, brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- Struktura, që ndikohen pak nga çedimi, me mundësie për zgjidhje me tipe vendndodhesh të ndryshme të themelimit apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës, varion aftësia mbajtëse dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- Struktura, që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi zgjidhjeje me një lloj të vetëm themeli, shtresimi i parregullt i nëntokës, aftësia mbajtëse fuqimisht e ndryshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

iv) Grupi IV tarifar:

Punimi i themeleve, që përfshin një shkallë, mbi mesatare, vështirësie në mënyrë specifike:

- Struktura, që ndikohen shumë nga çedimi, me shtresëzim të parregullt të nëntokës dhe aftësi të ndryshme mbajtëse dhe mundësi mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- Struktura, që ndikohen nga çedimi, me mundësi për zgjidhje me tipe vendndodhesh të ndryshme të themeli apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës dhe aftësi mbajtëse fuqimisht e ndryshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit;
- Struktura, që ndikohen pak nga çedimi, me mundësi për zgjidhje me tipe vendndodhesh të ndryshme të themeli, apo tensione të lokalizuara fuqimisht të ndryshme, me shtresim të parregullt të nëntokës dhe aftësi mbajtëse fuqimisht e ndryshme dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

v) Grupi V tarifar:

Punimi i themeleve që përfshin një shkallë shumë të lartë të vështirësisë, në mënyrë specifike:

- Struktura, që ndikohen shumë nga çedimi, shtresimi i parregullt i nëntokës, kapaciteti mbajtës fuqimisht i ndryshëm dhe mundësi çedimi brenda sipërfaqes së ndërtimit.

1.2.3.2. Neni 40, paragrafi 3, aplikohet në përputhje me rrethanat.

1.2.3.3. Tabela e mëposhtme përcakton tarifat për shërbimet e renditura në pikën

1.2.2.1, lidhur me vlerësimin e nëntokës dhe punën këshilluese për themele.

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE NE LIDHJE ME VLERËSIMIN E NËNTOKËS DHE PUNIMET E THEMELIT																
KOSTOT E LLOGARITSHME LEKE	GRUPI TARIFOR I			GRUPI TARIFOR II			GRUPI TARIFOR III			GRUPI TARIFOR IV			GRUPI TARIFOR V			
	Nga %	Deri %		Nga %	Deri %		Nga %	Deri %		Nga %	Deri %		Nga %	Deri %		
7,158,060	0.54	0.97		0.97	1.40		1.40	1.84		1.84	2.26		2.26	2.70		
10,500,000	0.45	0.80		0.80	1.14		1.14	1.49		1.49	1.83		1.83	2.18		
14,000,000	0.39	0.69		0.69	0.98		0.98	1.27		1.27	1.56		1.56	1.86		
21,000,000	0.32	0.56		0.56	0.79		0.79	1.02		1.02	1.25		1.25	1.48		
28,000,000	0.28	0.48		0.48	0.68		0.68	0.87		0.87	1.07		1.07	1.26		
35,000,000	0.25	0.43		0.43	0.60		0.60	0.77		0.77	0.94		0.94	1.12		
42,000,000	0.23	0.39		0.39	0.54		0.54	0.70		0.70	0.85		0.85	1.01		
49,000,000	0.22	0.36		0.36	0.50		0.50	0.64		0.64	0.78		0.78	0.93		
56,000,000	0.20	0.34		0.34	0.47		0.47	0.60		0.60	0.73		0.73	0.86		
63,000,000	0.19	0.31		0.31	0.44		0.44	0.56		0.56	0.68		0.68	0.80		
70,000,000	0.18	0.30		0.30	0.41		0.41	0.53		0.53	0.64		0.64	0.76		
105,000,000	0.15	0.24		0.24	0.33		0.33	0.42		0.42	0.51		0.51	0.61		
140,000,000	0.13	0.21		0.21	0.29		0.29	0.36		0.36	0.44		0.44	0.52		
210,000,000	0.11	0.17		0.17	0.23		0.23	0.29		0.29	0.35		0.35	0.41		
280,000,000	0.10	0.15		0.15	0.20		0.20	0.25		0.25	0.30		0.30	0.35		
350,000,000	0.09	0.13		0.13	0.18		0.18	0.22		0.22	0.27		0.27	0.31		
420,000,000	0.08	0.12		0.12	0.16		0.16	0.20		0.20	0.24		0.24	0.28		
490,000,000	0.07	0.11		0.11	0.15		0.15	0.18		0.18	0.22		0.22	0.26		
560,000,000	0.07	0.10		0.10	0.14		0.14	0.17		0.17	0.20		0.20	0.24		
630,000,000	0.06	0.10		0.10	0.13		0.13	0.16		0.16	0.19		0.19	0.22		
700,000,000	0.06	0.09		0.09	0.12		0.12	0.15		0.15	0.18		0.18	0.21		
1,050,000,000	0.05	0.07		0.07	0.10		0.10	0.12		0.12	0.14		0.14	0.17		
1,073,712,920	0.06	0.08		0.08	0.11		0.11	0.14		0.14	0.16		0.16	0.19		
2,100,000,000	0.04	0.05		0.05	0.07		0.07	0.08		0.08	0.10		0.10	0.11		
2,800,000,000	0.03	0.04		0.04	0.06		0.06	0.07		0.07	0.08		0.08	0.10		
3,500,000,000	0.03	0.04		0.04	0.05		0.05	0.06		0.06	0.07		0.07	0.09		
3,579,043,160	0.03	0.04		0.04	0.05		0.05	0.06		0.06	0.07		0.07	0.09		

Tabela. 4 Tabela shoqëruese e tarifave për vlerësimin e nëntokës dhe punimet të themelit.

1.3 Shërbimet e rilevimit topografik

1.3.1 Fusha e veprimit

1.3.1.1. Shërbimet e rilevimit topografik nënkuptojnë mbledhjen e të dhënave të veprave ndërtimore dhe të komplekseve të parcelave dhe topografisë, prodhimin e planeve/planshetave, transferimin e projekteve në terren, si dhe mbikëqyrjen e realizimit në aspektin topografik, si dhe shërbime, të cilat duhet të kryhen duke përdorur teknika dhe instrumenta topografikë.

1.3.1.2. Shërbimet e rilevimit topografik mund të përfshijnë:

- Rilevim për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave për veprat inxhinierike dhe për strukturat e transportit dhe qarkullimit,
- Rilevim i objekteve për ndërtim dhe për dokumentacionin përfundimtar për objektet ndërtimore, për veprat inxhinierike dhe për strukturat e transportit dhe qarkullimit,
- Rilevime dhe matje, në lidhje me objektet mbas fazës së projektimit dhe të ndërtimit, shërbime për rilevime, që nuk janë të lidhura me objektin, mbledhja e të dhënave gjeografike dhe gjeometrike, si dhe shërbime të tjera, të lidhura me rilevime.

1.3.2 Bazat e tarifimit për shërbimet topografike në fazën e projektimit

1.3.2.1. Tarifa për shërbime bazë, të rilevimit të projektit varet nga kosto e llogaritshme e objektit, grupi tarifor, në të cilën bën pjesë shërbimi i rilevimit topografik të projektit, si dhe nga tabela e parashikuar në pikën 1.3.8.

1.3.2.2. Kostot e llogaritshme mund të përcaktohen në bazë të llogaritjes së kostos së ndërtimit, përveç, nëse kjo nuk është në dispozicion, ose në bazë të vlerësimit të kostos, në qoftë se palët kontraktuese bien dakord me shkrim në një kontratë paraprake.

1.3.2.3. Kostot e llogaritshme mund të jenë kostot e realizimit të objektit. Ato do të llogariten në bazë të Nenit 4, si dhe:

1. Në rastin e ndërtesave dhe ndarjeve funksionale të tyre Neni 22;
2. Në rastin e veprave inxhinierike Neni 31;
3. Në rastin e strukturave të transportit dhe qarkullimit Neni 35;
4. Në rastin e PPV-ve dhe PDV-ve, si kosto e llogaritshme do të merret tarifa e planifikuesit urban, e cila llogaritet sipas Kreut II.

1.3.2.4. Në rastin ndërtesave, veprave inxhinierike dhe PDV, si kosto e llogaritshme do të merret kostoja e ndërtesave, veprave inxhinierike dhe PDV-ve, në paragrafin 1.3.2.3, pasi i nënshtrohet rregullit të përqindjeve të mëposhtme:

- i) Nën 25,000,000 lekë, 25%;
- ii) Ndërmjet 25,000,000 dhe 50,000,000 lekë, 20%;

- iii) Ndërmjet 50,000,000 dhe 100,000,000 lekë, 18%;
- iv) Mbi 100,000,000 lekë, 15%.

Në rastin e PPV-ve, si kosto e llogaritshme do të merret kostoja e PPV-ve, në paragrafin 1.3.2.3, pasi i nënshtrohet rregullit të përqindjeve të mëposhtme:

- i) Nën 25,000,000 lekë, 20%;
- ii) Ndërmjet 25,000,000 dhe 50,000,000 lekë, 15%;
- iii) Ndërmjet 50,000,000 dhe 100,000,000 lekë, 13%;
- iv) Mbi 100,000,000 lekë, 10%.

Në rastin e strukturave të transportit dhe qarkullimit, si kosto e llogaritshme do të merret kostoja ndërtimit të tyre.

1.3.2.5. Paragrafët 1.3.2.1 deri 1.3.2.4, që janë më lart dhe pikat 1.3.3 dhe 1.3.4 nuk aplikohen për shërbimet e rilevimit topografik, në lidhje me kabllot nën dhe mbi tokë, instalimet e transportit urban me trafik kryesisht urban, përveç rrugëve ujore, këmbësore, biçikletash dhe instalimi i platformave hekurudhore. Tarifimi për projektet e listuara në këtë paragraf mund të vendosen me negociim të lirë midis palëve.

1.3.2.6. Kur një detyrë përfshin më shumë se një objekt shërbimi, atëherë tarifat mund të llogariten të veçuara.

1.3.3 Grupet tarifore për shërbimet e rilevimit topografik, në fazën e projektimit

Grupet tarifore të shërbimeve të rilevimit topografik përcaktohen në bazë të vlerësimeve të mëposhtme:

1.3.3.1. Shërbimet sipas grupeve tarifore:

i) Grupi I tarifor:

Shërbime për të cilat ka kërkesa minimale për topografinë, përfshijnë:

- cilësi shumë të lartë të hartave ekzistuese,
- kërkesa minimale për saktësi,
- cilësi shumë të lartë për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë,
- probleme minimale për sa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit,
- pengesa minimale nga zhvillimi ose bimësia,
- pengesa minimale nga trafiku,
- dendësia minimale e karakteristikave topografike.

ii) Grupi II tarifar:

Shërbime, për të cilat ka kërkesa të ulëta për topografinë, përfshijnë:

- cilësi të mirë të hartave ekzistuese,
- kërkesa modeste për saktësi,
- cilësi e lartë për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë,
- probleme të vogla, për sa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit,
- pengesa të vogla nga zhvillimi ose bimësia,
- pengesa të vogla nga trafiku,
- dendësi të ulët e karakteristikave topografike.

iii) Grupi III tarifar:

Shërbime, për të cilat ka kërkesa mesatare për topografinë, përfshijnë:

- cilësi të kënaqshme të hartave ekzistuese,
- kërkesa mesatare për saktësi,
- cilësi mesatare për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë,
- probleme mesatare, për sa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit,
- pengesa mesatare nga zhvillimi ose bimësia,
- pengesa mesatare nga trafiku,
- dendësi mesatare e karakteristikave topografike.

iv) Grupi IV tarifar:

Shërbime për të cilat ka kërkesa mbi mesataren për topografinë, përfshijnë:

- cilësi pothuajse e përshtatshme të hartave ekzistuese,
- kërkesa mbi mesataren për saktësi,
- cilësi pothuajse të përshtatshme për vargun e pikave ekzistuese për pozicionimin, si dhe pikave fikse të lartësisë,
- probleme mbi mesataren, për sa i përket natyrës së terrenit dhe aksesit të këmbësorit,
- pengesa mbi mesataren nga zhvillimi ose bimësia,
- pengesa mbi mesataren nga trafiku,
- dendësi mbi mesataren e karakteristikave topografike.

v) Grupi V Tarifar:

Rilevime me kërkesa të larta topografike, përfshijnë:

- harta ekzistuese jo cilësore,
- kërkesa me saktësi të lartë,
- të dhëna jo cilësore mbi pozicionin dhe lartësinë e pikave të palëvizshme ekzistuese,
- probleme të rënda për sa i përket natyrës së tokës dhe kalimeve të këmbësorëve,
- pengesa shumë të mëdha nga bimësia,

- pengesa shumë të mëdha nga trafiku,
- dendësi shumë e lartë topografike.

1.3.3.2. Kur një ose më shumë grupe tarifore plotësojnë kriteret e nevojshme në lidhje me projektin e rilevimit, është vështirë të përcaktohet se cili grup tarifor është i përshtatshëm për projektin. Në këtë rast është e nevojshme që të saktësohet një sistem i pikëzimit, sikurse përshkruhet në paragrafin 1.3.3.3. më poshtë, si dhe të përcaktohet grupi tarifor, bazuar në shumën totale të pikëve. Rilevimi mund të klasifikohet në grupet e mëposhtme tarifore:

- i) Grupi I tarifor: Rilevim deri në 14 pikë;
- ii) Grupi II tarifor: Rilevim nga 15-25 pikë;
- iii) Grupi III tarifor: Rilevim nga 26-37 pikë;
- iv) Grupi IV tarifor: Rilevim nga 38-48 pikë;
- v) Grupi V tarifor: Rilevim nga 49-60 pikë.

1.3.3.3. Për të përcaktuar grupin e saktë tarifor për shërbimet e topografisë në fazën e projektimit, vlerësimi me pikë bëhet duke reflektuar në shkallën e vështirësisë së kërkesave të vëna nga topografi për kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

- i) cilësia e hartave ekzistuese,
- ii) kërkesa në lidhje me saktësinë e cilësinë e përmasave ekzistuese të pozicionit dhe lartësisë për pikat e palëvizshme,
- iii) të dhëna mbi pozicionin dhe lartësinë e pikave të palëvizshme ekzistuese,
- iv) probleme për sa i përket natyrës së tokës dhe kalimeve të këmbësorëve,
- v) pengesat nga bimësia,
- vi) pengesat nga trafiku,
- vii) densiteti i karakteristikave topografike.

Për të caktuar grupin e saktë të tarifave të rilevimit topografik, bëhet vlerësimi si më poshtë:

- Pika i), ii) dhe iii) 0-5 pikë;
- Pika iv) v) dhe vi) 0-10 pikë;
- Pika vii) 0-15 pikë.

1.3.4 Shërbimet topografike në fazën e projektimit sipas tipologjisë

1.3.4.1 Kuadri i shërbimit të rilevimit topografik në fazën e projektimit përfshijnë shërbimet topografike tokësore, fotogrametrike, për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave, të veprave inxhinierike, të strukturave të transportit dhe qarkullimit. Këto shërbime bazë janë përmbledhur në gjashtë faza dhe vlerësohen, mbi bazën e përqindje ndaj tarifës së shërbimit, përcaktuar në pikën 1.3.8.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse, jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1.	Faza I	Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit	3%
2.	Faza II	Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike	15%
3.	Faza III	Planet e pozicionimit dhe të rilevimit	52%
4.	Faza IV	Vizatime të piketave	15%
5.	Faza V	Projekti i zbatimit: Piketat për qëllime planifikimi	5%
6.	Faza VI	Seksionet gjeologjike	10%

Tabela. 5 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për rilevimet topografike.

1.3.4.2 Tipologjitë e shërbimit mund të përfshijnë, si më poshtë:

Shërbimet bazë 1) Faza I: Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit Gjetja dhe marrja e informacionit dhe dokumentacionit në vendndodhjen ku është planifikuar objekti. Gjetja e dokumentacionit të rilevimit. Inspektimi në vend. Vendosja e qëllimit të projektit e lidhur relativisht me kërkesat e saktësisë dhe shkallën e vështirësisë.	Shërbime të veçanta ➤ Marrja e lejeve me shkrim për të hyrë në truallin për ndërtim, leje transporti në ujë dhe leje për masat e sigurisë ndaj trafikut që kërkon autorizim.
---	---

Shërbime bazë

2) Faza II: Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike

Identifikimi dhe shënimi i pikave për pozicionim dhe rilevim. Hartimi i përshkrimeve për pikat e palëvizshme dhe shoqëruar me skemat përkatëse. Kryerja e matjeve për të përcaktuar pikat fikse dhe ato të kontrollit. Analizimi i matjeve dhe hartimi i rrjetit mbështetës gjeodezik dhe atë të rilevimit.

3) Faza III: Planet e pozicionimit dhe të rilevimit

Studimet topografike/morfologjike (tokësore/ajrore) duke përfshirë regjistrimet e pikave kufizuese. Analiza e matjeve/fotografive ajrore. Hartimi i planeve që paraqesin situatën e objektit duke përfshirë zonën e mbuluar nga projekti dhe të dhënat kadastrale. Paraqitja erilevimeve në format të pikëzuar, matrica ose në formë vizash konturuese. Hartimi i një model terreni të dixhitalizuar. Prezantim grafik i kanaleve, rrjetit elektrik, kabllot dhe strukturat nëntokësore sipas dokumentacionit ekzistues. Përfshi rregullat zyrtare bashkëkohore. Të gjitha matjet të jenë në format dixhital.

Shërbime të veçanta

- Analiza e rrjetit dhe grafikut të punimeve të rilevimit për rrjete tokësore shumë ekzakte.
- Shënimi i piketave për kërkesa të veçanta.
- Instalimi i pikave fikse dhe stacionet.

Shërbime të veçanta

- Përcaktimi dhe rilevimi i strukturave nëntokësore.
- Rilevimi nëntokë, nënujë ose natën.
- Masa të shumta për sigurinë nga trafiku që kërkojnë autorizim.
- Regjistrime të detajuara të projekteve ekzistuese dhe strukturave ekzistuese duke tejkaluar standardet normale topografike; p.sh. fasadat, dhe hapësirat e brendshme të ndërtesave.
- Përfshirja e të dhënave të pronësisë.
- Paraqitja e të dhënave në shkallë të ndryshme.
- Rilevim jashtë zonës të mbuluar nga plani.
- Përgatitja e planeve të pozicionit në lidhje me kërkesat ligjore për procedurat e pranimit zyrtar.
- Matje dhe regjistrime të kurorave të pemëve.

4) Faza IV: Vizatime të piketave

Llogaritja e matjeve gjeometrike bazuar në projekt dhe përpilimi i dokumentacionit dhe piketimit

- Piketimi për projektin
- Përcaktimi dhe transferimi i vijës referenciale për objekte lineare në kantier
- Përcaktimi dhe transferimi i gjeometrisë së projektit në kantier për procedurat e orientimit dhe të vendosjes së kondicioneve urbane.

5) Faza V: Projekti i zbatimit: Piketat për qëllime planifikimi

- Transferimi në terren i vijës referenciale për objektet lineare (p.sh. kufiri i ndërtimit)
- Transferimi i gjurmës së projektit në terren për kontrollin e aktit të piketimit të objektit nga organet kompetente.

6) Faza VI: Seksionet gjellogjike

- Identifikimi dhe paraqitja e profileve gjatësore dhe tërthore nga matjet tokësore dhe fotogrametrike.

Shërbime të veçanta

- Realizimi i llogaritjeve optimale që kanë të bëjnë me gjeometrinë e ndërtesave (përdorimi i tokës, ndarjet dhe sipërfaqet rrugore).

1.3.5 Bazat e tarifimit për shërbimet topografike në fazën e ndërtimit

1.3.5.1 Tarifat për shërbimet bazë lidhur me rilevimet për ndërtime, janë përcaktuar duke ju referuar kostove të llogaritshme të objektit, grupit tarifar në të cilin përfshihet projekti i rilevimit dhe tabelës së tarifave në pikën 1.3.8.

1.3.5.2 Kostot e llogaritshme mund të llogariten sipas pikës 1.3.2.3. Baza e llogaritjes së tarifës për shërbimin topografik në fazën e ndërtimit merret:

- i) 80% të kostove të llogaritshme në strukturat e transportit dhe qarkullimit;
- ii) 60% e kostove të llogaritshme në ndërtesat dhe në veprat inxhinierike.

1.3.5.3 Paragrafët 1.3.5.1 dhe 1.3.5.2 me sipër dhe pikat 1.3.6 dhe 1.3.7 nuk aplikohen për shërbime rilevimi që kanë të bëjnë me kabllotmbi dhe nën tokë, tunele, galeri ose shpella, instalimet e transportit urban dhe kryesisht trafikun urban përveç rrugëve ujore, dhe kalimeve të kalimtarëve e për biçikleta, dhe instalimet e platformave hekurudhore. Çmimi për projektet e sipërpërmendura mund të negociohet më vete.

1.3.6 Grupet tarifore për shërbime të rilevimit

1.3.6.1 Grupet tarifore për rilevimin mund të përcaktohet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- i) Grupi I tarifar:

Rilevime që kanë kërkesa minimale topografike, që përfshijnë:

- Ndikimi minimal nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- Pengesa minimale nga ndërtimi dhe bimësia;
- Pengesa minimale nga trafiku;
- Kërkesa minimale për saktësinë;
- Kërkesa minimale në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- Pengesa minimale nga veprimtaritë në kantier.

- ii) Grupi II tarifar:

Rilevime që kanë kërkesa të vogla topografike, që përfshijnë:

- Ndikimi i vogël nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- Pengesa të vogla nga ndërtimi dhe bimësia;
- Pengesa të vogla nga trafiku;
- Kërkesa të vogla për saktësinë;
- Kërkesa minimale në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- Pengesatë vogla nga veprimtaritë në kantier.

iii) Grupi III tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa mesatare topografike, që përfshijnë:

- Ndikimi mesatar nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- Pengesa mesatare nga ndërtimi dhe bimësia;
- Pengesa mesatare nga trafiku;
- Kërkesa mesatare për saktësinë;
- Kërkesa mesatare në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- Pengesa mesatare vogla nga veprimtaritë në kantier.

iv) Grupi IV tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa mbi-mesatare topografike, që përfshijnë:

- Ndikimi mbi mesatar nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- Pengesa mbi mesatare nga ndërtimi dhe bimësia;
- Pengesa mbi mesatare nga trafiku;
- Kërkesa mbi mesatare për saktësinë;
- Kërkesa mbi mesatare në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- Pengesa mbi mesatare vogla nga veprimtaritë në kantier.

v) 5. Grupi V tarifor:

Rilevime që kanë kërkesa të larta topografike, që përfshijnë:

- Ndikimi shumë të lartë nga struktura e relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- Pengesa shumë të larta nga ndërtimi dhe bimësia;
- Pengesa shumë të larta nga trafiku;
- Kërkesa shumë të larta për saktësinë;
- Kërkesa shumë të larta në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- Pengesa shumë të larta nga veprimtaritë në kantier.

1.3.6.2 Pika 1.3.3 paragrafi 1.3.3.2 aplikohet sipas rastit.

1.3.6.3 Për të përcaktuar grupin e saktë tarifor për sa i përket projektit të rilevimit, pikët duhet të vlerësohen duke reflektuar shkallën e vështirësisë së kërkesave të vëna nga topografia për kriteret e vlerësimit si më poshtë:

- i) Ndikimi i strukturave të relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të;
- ii) Pengesa nga ndërtimi dhe bimësia;

- iii) Pengesa nga trafiku;
- iv) Kërkesa për saktësinë;
- v) Kërkesa në lidhje me gjeometrinë e objektit;
- vi) Pengesa nga veprimtaritë në kantier.

Pika i), 0-5 pikë

Pika ii) iii) iv) dhe v) 0-10 pikë

Pika v) 0-15 pikë

Pasi të jetë bërë vlerësimi i pikëzuar duhet ti referohemi paragrafit 1.3.3.2 për të përcaktuar grupin tarifor.

1.3.7 Shërbimet topografike në fazën e ndërtimit sipas tipologjisë

1.3.7.1 Kuadri i shërbimit të rilevimit topografik në fazën e ndërtimit përfshijnë shërbimet topografike tokësore, fotogrametrike, për planifikimin dhe për projektimin e ndërtesave, të veprave inxhinierike, të strukturave të transportit dhe qarkullimit. Këto shërbime bazë janë përmbledhur nëkatër faza dhe vlerësohen, mbi bazën e përqindje ndaj tarifës së shërbimit, përcaktuar në pikën 1.3.8.

Fazat e shërbimit dhe përqindjet përkatëse, jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza I	Shërbimet këshilluese për gjeometrinë e ndërtesës	2%
2	Faza II	Piketime për ekzekutim	14%
3	Faza III	Matja e realizimit të punimeve	66%
4	Faza IV	Mbikëqyrja e aspekteve topografike në zbatim	18%

Tabela. 6 Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për rilevimet topografike, shërbimet e veçanta.

1.3.7.1 Tipologjitë e shërbimeve, mund të përfshijnë si më poshtë:

Shërbimet bazë

1) Faza I: Shërbimet këshilluese për gjeometrinë e ndërtesës

- Këshillim gjatë fazës së projektimit, vecanërisht në aspektin e kërkesave të saktësisë dhe të tolerancave, konceptimi i një programi matës, përcaktimi i masave si sistem referencial dhe emërtimi i tyre. Përcaktimi i një programi për matjet e lëvizshme dhe për deformimet përfshirë punët përgatitore dhe ndihmëse në kantier.

2) Faza II: Piketime për ekzekutim

- Përcaktimi i pikës gjeodezike;
- Përcaktimi dhe transferimi i pikave të palëvizshme, horizontale dhe vertikale;
- Përgatitja e skicave të rilevimit dhe i përshkrimit të pikave referenciale;
- Matja për përcaktimin e pikave të palëvizshme dhe të ndërmjetme;
- Vlerësimi i matjeve dhe përgatitja e të dhënave mbi koordinatat dhe lartësitë.

3) Faza III: Matja e realizimit të punimeve

- Përgatitja e planit të rilevimit dhe kuotave;
- Matje për të prodhuar të tjera pika pozicioni dhe pika të palëvizshme dhe të ndërmjetme

Shërbime të veçanta

- Përpilim i grafikut të punimeve për specifikimet e projektit të rilevimit;

- Përgatitja e propozimeve organizative për ndarjet e kompetencave të përgjegjësisë për pikat e takimit gjatë matjes së objektit.

- Piketimi duke patur parasysh deformimet nën ndikimin e ngarkesave teknike dhe realizimit/prodhimit:

- Matje për të kontrollimin dhe mbajtjen e pikavetë palëvizshme dhe të ndërmjetme; - Piketime për shoqërimin e vazhdueshëm të pikave strukturore për pozicionim në plan dhe lartësi. - Matje për të regjistruar lëvizjet dhe deformimet e objektit gjatë ndërtimit për pika të rëndësishme strukturore (nuk është shërbim bazë për punimet në akuadukte). Matje për kontroll. - Regjistrime të vazhdueshme gjatë ekzekutimit, të cilat do të reflektohen në vizatimet e hartuara pas ndërtimit. 4) Faza IV: Mbikëqyrja e aspekteve topografike në zbatim ➤ Kontrolli gjatë zbatimit të projektit për kryerjen e provave/matjeve të formave të betonit, dhe komponentëve strukturore; ➤ Hartimi i raporteve të rilevimit; ➤ Kryerja e provave/matjeve për lëvizje dhe deformim gjatë ndërtimit për pikat kryesore strukturore.	- Testime për saktësinë e dimensioneve për komponentët e parafabrikuara; - Matja e punimeve të ndërtimit aty ku kërkohet rilevim i veçantë; - Hartimi i vizatimeve gjatë ekzekutimit; - Hartimi i vizatimeve të metejshme pas përfundimit të shërbimeve bazë. Shërbime të veçanta ➤ Kontrolli i llogaritjeve sasiore; - Hartimi dhe zbatimi i një programi afatgjatë për monitorimin e rilevimit me qëllim mbikëqyrjen e ndërtesës; - Matje në mbështetje të pranimit të punëve në ndërtesë ku ka kërkesa të veçanta për rilevim.
--	--

1.3.7.2 Pavarësisht paragrafit 1.3.7.1, tarifat për Fazën III të shërbimit, mund të tarifohen deri në 45-66% në rastin e ndërtesave.

1.3.8 Tabela e tarifave për shërbimet bazë lidhur me rilevimet topografike.

Tabela e mëposhtme e tarifave përcakton tarifat për shërbimet e renditura në pikën 1.3.1 lidhur me rilevimet topografike.

TABELA SHOQËRUESE E TARIFAVE NË LIDHJE ME TOPOGRAFINË												
KOSTOT E LLOGARITSHME LEKË	GRUPI TARIFOR I		GRUPI TARIFOR II		GRUPI TARIFOR III		GRUPI TARIFOR IV		GRUPI TARIFOR V			
	NGA	DERI	NGA	DERI	NGA	DERI	NGA	DERI	NGA	DERI		
	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%		
3,000,000	2.12	2.43	2.43	2.74	2.74	3.04	3.04	3.43	3.43	3.66		
5,000,000	1.94	2.25	2.25	2.56	2.56	2.86	2.86	3.25	3.25	3.48		
7,000,000	1.76	2.07	2.07	2.38	2.38	2.68	2.68	3.07	3.07	3.30		
14,000,000	1.33	1.53	1.53	1.73	1.73	1.93	1.93	2.13	2.13	2.33		
21,000,000	1.15	1.31	1.31	1.48	1.48	1.64	1.64	1.80	1.80	1.97		
28,000,000	1.03	1.17	1.17	1.31	1.31	1.44	1.44	1.59	1.59	1.72		
35,000,000	0.94	1.06	1.06	1.19	1.19	1.31	1.31	1.44	1.44	1.56		
42,000,000	0.87	1.05	1.05	1.10	1.10	1.21	1.21	1.32	1.32	1.43		
49,000,000	0.82	0.93	0.93	1.03	1.03	1.13	1.13	1.24	1.24	1.34		
56,000,000	0.79	0.89	0.89	0.98	0.98	1.08	1.08	1.18	1.18	1.28		
63,000,000	0.76	0.85	0.85	0.94	0.94	1.04	1.04	1.13	1.13	1.22		
70,000,000	0.73	0.82	0.82	0.91	0.91	1.00	1.00	1.09	1.09	1.18		
105,000,000	0.60	0.68	0.68	0.75	0.75	0.82	0.82	0.89	0.89	0.96		
140,000,000	0.54	0.60	0.60	0.66	0.66	0.72	0.72	0.79	0.79	0.85		
210,000,000	0.47	0.52	0.52	0.58	0.58	0.63	0.63	0.68	0.68	0.74		
280,000,000	0.44	0.48	0.48	0.53	0.53	0.58	0.58	0.63	0.63	0.68		
350,000,000	0.42	0.46	0.46	0.51	0.51	0.55	0.55	0.60	0.60	0.65		
420,000,000	0.40	0.45	0.45	0.49	0.49	0.53	0.53	0.58	0.58	0.62		
490,000,000	0.39	0.44	0.44	0.48	0.48	0.52	0.52	0.56	0.56	0.61		
560,000,000	0.39	0.43	0.43	0.47	0.47	0.51	0.51	0.55	0.55	0.59		
630,000,000	0.38	0.42	0.42	0.46	0.46	0.50	0.50	0.54	0.54	0.59		
700,000,000	0.38	0.42	0.42	0.46	0.46	0.50	0.50	0.54	0.54	0.58		
1,050,000,000	0.36	0.40	0.40	0.44	0.44	0.48	0.48	0.52	0.52	0.56		
1,400,000,000	0.35	0.39	0.39	0.43	0.43	0.47	0.47	0.51	0.51	0.54		
1,431,617,320	0.35	0.39	0.39	0.43	0.43	0.47	0.47	0.51	0.51	0.54		

Tabela. 7 Tabela shoqëruese e tarifave për shërbimet e rrezeveve topografike.

Shtojca 2.

Ref. Nenit 3, paragrafi 3: Shërbimet e veçanta

2.1 Planifikimi i përgjithshëm vendor sipas tipologjive të shërbimit

Tipologjitë mund të përfshijnë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

2.1.1 Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse

- Planifikimi i specifikimeve të projektit;

2.1.2 Përgatitja e analizës së thelluar

- Modele terreni;
- Punime gjeodezike në objekt;
- Përditësimi i hartave;
- Prodhimi i hartave tëgjendjes në terren me cilësi të lartë për shumëfishim;
- Zhvillimi i një dokumentacioni bazë të projektit nga harta ,të burimeve të ndryshme;
- Analiza e fotove ajrore;
- Pyetësorë për të marrë statistika kryesore përfshirë këtu dhe analizën e materialeve dytësore;
- Survejime statistikore lokale, si dhe identifikimin e nevojave si atyre të furnizimit, ekonomike, sociale, infrastrukturës së strehimit, strukturave kulturele dhe sociale, aty ku nuk janë të përfshira në shërbimet bazë. Kërkime të detajuara për përdorimet aktuale.

2.1.3 Hartimi i planit paraprak

- Hartimi i "Dokumentit të Politikave", i cili përfshin:
- Hartimi i Profilit të Njesisë së Qeverisjes Vendore: ku përfshihen profili social, demografik, ekonomik, mjedisor, topografik, fizik, urban;
- Hartimi i Analizës S.W.O.T, ku përcaktohen pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet me të cilat përballlet NJ.Q.V.;
- Hartimi i Vizionit për Zhvillimin e Territorit dhe objektivate strategjike në

mbështetje të vizionit;

- Hartimi i Programeve dhe Politikave në Mbështetje të objektivave strategjike;
- Hartimi i Planit të veprimit për realizimin e vizionit dhe objektivave strategjike për zhvillimin e territorit.

Këshillohet që Dokumenti i politikave të hartohet nga vetë Nj.Q.V. Në rastin e pamundësisë ose për pamjaftueshmërisë të burimeve njerëzore në Njësine e Qeverisjes Vendore ose Qendrore, ky shërbim mund të porositet, por në asnjë rast nuk duhet të konsiderohet si një shërbim, i cili mund të kryhet në mënyrë krejtësisht të pavarur nga grupi i Nj.Q.V. Grupi i Nj.Q.V. duhet të bashkëpunojë me grupin e ofruesve të shërbimit, që në këtë rast janë planifikuesit urbanë.

- i) Asistimi i klientit në marrëdhëniet me publikun, përfshirë këtu broshurat informative, diskutime me publikun si dhe përpilimi i dokumenteve të nevojshme narrative dhe grafike;
- ii) Prodhimi i axhendave të mbledhjeve, dokumentet dhe raportet;
- iii) Përgjegjësi për përfshirjen e autoriteteve dhe institucioneve publike, që mund të jenë ndikuar nga plani.

2.1.4 Hartimi i planit përfundimtar

- Prodhimi i planeve ndihmës, si ato për trafikun, strukturat infrastrukturore, riparcelizimi, planet për shtigjet dhe lëvizjen e ujërave, hartat e pronësisë dhe harta për kriteret e cilësisë, duke marrë parasysh planet e prodhuara nga specialistë të tjerë në ekipin e planifikimit;
- Ndryshime kryesore, ose rishikim total të planeve pas ndërtimit, sidomos kur këto hartohen në përgjigje të kritikave apo sugjerimeve;
- Përgatitja e dokumenteve keshilluese për autoritetet lokale në përgjigje të kritikave dhe sugjerimeve;
- Përmbledhje e detajuar për shfrytëzim.

2.1.5 Hartimi i rregullores

2.1.6 Projekti përfundimtar për miratim

- Shërbime për printim;
- Prodhimi i kopjeve shtesë me ngjyra, të planeve të zonimit (Plani i përdorimit të tokës i propozuar, plani për zhvillimin e infrastrukturës dhe fazat e zbatimit);
- Rishikimi i vizatimeve dhe raporteve shpjegues pas aprovimit.

2.2 Planifikimi i detajuar vendor sipas tipologjive të shërbimit

Planifikimi i specifikimeve të projektit;

Tipologjitë mund të përfshijnë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

2.2.1 Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse

- Identifikimi i natyrës dhe shkallës sëçdo hetimi shtesë që mund të nevojitet, veçanërisht për rastet e zonave që janë tashmë të zhvilluara;
- Kthim përgjigje i çdo propozimi individual, hasur gjatë përgatitjes së planit.

2.2.2 Përgatitja e analizës së thelluar

- Mbledhja e të dhënave gjeodezike;
- Pyetësorët fillestarë (pyetësorë, aprovimi i projektit);
- Hetimet shtesë, aty ku nuk ekziston planifikim zonal;
- Ofrimi i ndihmës për identifikimin e mundësive të financimit nga burime publike;
- Analiza vizuale e qytetit.

2.2.3 Hartimi i planit paraprak

- Hartimi i modeleve paraprake.

2.2.4 Hartimi i planit përfundimtar

- Vlerësimi dhe prezantimi i masave për mbrojtjen e mjedisit.

2.2.5 Projekti përfundimtar për miratim

- Prodhimi i kopjeve me ngjyrë të planit vendor të zhvillimit.

2.3 Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të brendshme sipas tipologjive të shërbimit

Tipologjitë mund të përfshijnë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

2.3.1 Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Inventarizim fillestar;
- Analizimi në vend;
- Planifikimi operacional;
- Prodhimi i një grafiku punimesh për përdorimin e hapësirës;
- Përgatitja e një grafiku punimesh për funksionalitetin;
- Kontroll për ndikimin mjedisor;
- Kontroll për pajtueshmërinë mjedisore.

2.3.2 Projekt idea paraprake

- Shqyrtim i zgjidhjeve alternative që do t'i nënshtrohen kërkesave rrënjësisht të ndryshme;
- Dokumenta shtese paraprake të projektimit për të pasqyruar kërkesat e veçanta;
- Përgatitja e një plani financimi;
- Përgatitja e analizës kosto-përfitim për fazën e ndërtimit dhe atëoperative;
- Ndihmame prokurimin e kredive;
- Kryerja e aplikimit paraprak (aplikimi për lejet e ndërtimit);
- Përgatitja e grafikutme afatet kohore dhe planin e veprimit;
- Përgatitja e prezantimeve me teknika bashkëkohore specifike duke përfshirë makete, vizatime perspektive, templeta, etj;
- Dokumente shtese paraprake të projektimit lidhur me masat e veçanta të ndërmarra për racionalizimin e ndërtimeve dhe përbërësve të veçantë, të cilat shkojnë përtej fushës normale të shërbimeve të detyrave të projektimit, në mënyrë që të zvogëlohet niveli i konsumit të energjisë dhe çlirimet e substancave të dëmshme dhe karbonit, si dhe për të shfrytëzuar burimet e ripërtëritshme të energjisë në konsultim me specialistët e tjerë të përfshirë në procesin e planifikimit. Fusha e zakonshme e veprimtarisë për masat e kursimit të energjisë është arritur nga përmbushja e kërkesave të përfshira në dispozitat ligjore dhe standardet teknike të pranuar.

2.3.3 Projekt idea përfundimtare

2.3.4 Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Ndihma me marrjen e pëlqimit të pronarëve të pronave ngjitur;
- Përgatitja e dokumentacionit për procedurat e veçanta të aprovimit;
- Ofrimi i mbështetjes teknike dhe organizative për klientin gjatë procedurave të apelit, veprimeve juridike/gjyqësore e të tjera të kësaj natyre;
- Rishikim i dokumentacionit në rrethana që ndodhin jashtë kontrollit të ofruesit.

2.3.5 Projekti i zbatimit

- Përgatitja e një përshkrimi të detajuar të projektit në formën e një "libri të ndërtimit", për të shërbyer si bazë për specifikimet e projektit dhe grafikut të punimeve¹;
- Përgatitja e një përshkrimi të detajuar të projektit në formën e një libri të shfrytëzimit të hapësirës, për të shërbyer si bazë për specifikimet e projektit dhe grafikut të punimeve;
- Kontrolli i planeve të zbatimit të përgatitura nga kontraktuesi i ndërtimit, bazuar në specifikimet e projektit dhe grafikun e punimeve për përputhje me planet përfundimtare;
- Zhvillimi i librezës së masave;
- Kontrolli dhe pranimi i vizatimeve të prodhuara nga specialistët e palës së tretë të përfshirë në planifikimin e projektit për përputhje me vizatimet e zbatimit (vizatime nga ofruesit, vizatimet e instalimeve të ndryshme dhe të themeleve dhe vizatimet e ofruara nga ofruesit e makinerive) në rastin kur këto shërbime kanë të bëjnë me sisteme që nuk mbulohen në kostot e llogaritshme.

2.3.6 Preventivi përfundimtar

- Përgatitja e preventivit dhe programit të punës duke iu referuar librit të ndërtimit¹ [dokumentacioni bazë për menaxhimin e projektit (project management)] dhe librit të hapësirave² [libri bazë i ndarjes /emërimit/përkufizimit të hapësirave dhe sipërfaqeve të projektit];
- Përgatitja e specifikimeve alternative të projektit për zonat e shërbimeve të veçanta;
- Përgatitja e përmbledhjes së kostove krahasuese, duke vlerësuar kontributet e bëra nga specialistë të tjerë të përfshirë në planifikimin e projektit.

¹Aty ku ekzistojnë specifikimet e projektit, si dhe grafiku i punimeve, ky shërbim i veçantë konsiderohet plotësisht ose pjesërisht një shërbim themelor.

2.3.7 Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit

- Kontroll dhe listim i tenderave dhe i preventivave të marra bazuar në specifikimet dhe grafikun e punimeve;
- Përgatitja, kontrolli dhe listimi i çmimeve sipas kërkesave të veçanta.

2.3.8 Mbikëqyrja

- Përgatitja, mbikëqyrja dhe përditësimi i grafikut tëpagesave;
- Përgatitja, mbikëqyrja dhe përditësimi i grafikut të punimeve, kostove dhe kapaciteteve;
- Përgjegjësi menaxhimi i kantierit në rastet kur aktiviteti konsiderohet nga ligjet në fuqi si shërbim që shkon përtej shërbimeve bazë të parashikuara në Fazën VIII.

2.3.9 Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudimi

- Vizatime të gjendjes ekzistuese;
- Përgatitja e listës së pajisjeve dhe inventarit;
- Përgatitja e udhëzimeve të mirëmbajtjes dhe kujdesit;
- Mbikëqyrja e objektit;
- Menaxhimi i objektit;
- Inspektime pas dorëzimit;
- Punime të mirëmbajtjes dhe kujdesi i mbikëqyrjes;
- Hartimi i të dhënave mbi fluksin e pagesave për objektin;
- Llogaritja dhe konfirmimi i kostove, referuar kostove udhëzuese standarde;
- Kontrolli i analizës së kostos të ndërtimit dhe kostos operacionale.

2.3.10 Shërbimet e veçanta për shndërim dhe modernizim

- Kryerja e matjeve për të kontrolluar dimensionet, faktorët teknike dhe deformimin;
- Përgatitja e hartës së dëmtimeve;
- Identifikimi i dëmtimeve;
- Masat e planifikimit dhe mbikëqyrjes e për krijimin e kushteve të sigurisë në strukturat ekzistuese;
- Ndihma me këshillim dhe mbështetje për përdoruesit dhe palët e tjera të prekura;

- Kontrolli i ndikimit të projektit të propozuar dhe masat për përdoruesit, p.sh. nga sondazhet me publikun.

2.4 Ambientet e jashtme sipas tipologjive të shërbimit

Tipologjitë për ambientet e jashtme mund të përfshijnë shërbimet e veçanta sipas pikës 2.3.

2.5 Veprat inxhinierike sipas tipologjive të shërbimit

Tipologjitë për punimet inxhinierike mund të përfshijnë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

2.5.1 Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Përzgjedhja dhe shqyrtimi i projekteve të ngjashme;
- Identifikimi i ngarkesave të veçanta të papërcaktuara në norma.

2.5.2 Projekt idea paraprake

- Përgatitja e analizës së kosto/përfitimit;
- Përgatitja e dokumentacionit topografik dhe hidrologjik;
- Llogaritja e saktë e elementeve të veçantë strukturorë,
- Koordinimi dhe paraqitja e pajisjeve dhe përcjellësve në rastin e ngarkesave lëvizëse;

2.5.3 Projekt idea përfundimtare

- Sigurimi i ekstrakteve kadastrale nga regjistrat kadastrale dhe dokumente të tjera zyrtare;
- Përditësimi i analizës kosto/përfitim;
- Llogaritja e sinjaleve teknike;
- Bashkëveprimi në marrëveshje administrative.

2.5.4 Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Bashkëveprimi në marrjen e pëlqimit nga palët e përfshira;
- Përgatitja e dokumenteve për punimet e themeleve.

2.5.5 Projekti i zbatimit

- Përgatitja e planeve të ndërthurura dhe proceseve;
- Planet e sistemeve për procedurën dhe procesin teknologjik për veprat inxhinierike, sipas nenit 30 pika i)-iii) dhe v), që i janë dhënë ofruesit, i cili ka ofruar gjithashtu shërbimet bazë për punimet inxhinierike përkatëse;
- Pavarësisht nenit 32, paragrafi 1, pika v), palët kontraktuese mund të bien dakord me shkrim në kontratë që veprat e inxhinierisë të përcaktuara nga neni 30 pika i)-iii) dhe v), mund të faturohen me më shumë se 15-35%, nëse këto vepra inxhinierike kërkojnë përpjekje mbi mesataren për projektin e zbatimit.

2.5.6 Bashkëveprimi në preventivimin dhe tenderim

Kontrolli i vlerave dhe i ofertave paralele, i propozimeve për ndryshim, që bazohet në konstruksione të ndryshme dhe analizave e realizueshmërisë teknike dhe funksionale.

2.5.7 Përkujdesja e objektit dhe dokumentacioni

Përkujdesja e objektit dhe dokumentacioni, ka si qëllim përgatitjen e librit të punës së objektit për realizimin dhe mbikëqyrjen e tij.

2.5.8 Mbikëqyrja e realizimit të objektit

- Mbikëqyrja dhe harmonizimi për realizimin e objektit për të siguruar konformitetin me projektin e miratuar, dokumentacionin përkatës, kontratën e ndërtimit dhe standardet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Piketimi i aksit kryesor të projektit në lidhje me pikat fikse në afërsi dhe prodhimi i pikave fikse të rilevimit në zonën e projektit, në rastet ku këto shërbime nuk kërkojnë instrumenta të veçanta ose teknika studimi;
- Piketimi i gjurmës së sheshit të ndërtimit;
- Mbajtja e ditarit të ndërtimit;
- Kryerja e matjeve në bashkëpunim me kompaninë operacionale;
- Ndihma në prokurimin e shërbimeve dhe furnizimeve;
- Kontrolli i faturave;
- Ndihma me procedurat e aprovimit nga autoriteti publik;
- Ndihma me mbikëqyrjen e kapacitetit funksional të elementeve dhe të sistemit në përgjithësi;
- Veprime korrigjuese nga vëzhgimi lidhur me mangësitë e identifikuara;

Për projekte të përcaktuara në nenin 30: mbikëqyrja e zbatimit të strukturave mbajtëse të përcaktuara në nenin 30, paragrafi 2, pikat 1 dhe 2, në lidhje me provat e përputhshmërisë së qëndrueshmërisë.

2.5.9 Shërbime të veçanta

- Të cilat lidhen me shndërrimin dhe modernizimin e veprave inxhinierike dhe strukturave të transportit me kosto minimale për punime tokësore, përfshirë brigjet dhe argjinaturat ekzistuese me pjerrësi të lidhura ose bashkime të vështira.
- Nxjerrja e të dhënave dhe rregulloreve lidhur me përmbajtjen e strukturës;
- Kërkimi dhe zbatimi i të gjitha masave të nevojshme të sigurisë për ndërtimin apo fazat e zbatimit;
- Kontrolli në vend i detajeve të projektimit në gjendjen ekzistuese dhe rishikimin e vizatimeve aty ku gjenden mospërputhje me origjinalet;
- Hartimi i një propozimi për të korrigjuar dëmtimet apo mungesat.

2.6 Strukturat e transportit dhe qarkullimit sipas tipologjive të shërbimit

Tipologjitë për strukturat e transportit dhe qarkullimit mund të përfshijnë shërbimet e veçanta, të pikës 2.5.

2.7 Planifikimi i strukturave mbajtëse sipas tipologjive të shërbimit

Tipologjitë mund të përfshijnë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

2.7.1 Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

2.7.2 Projekt idea paraprake

- Përgatitja e llogaritjeve krahasuese për disa zgjidhje alternative për kërkesa të ndryshme të projektit;
- Përgatitja e një pasqyre të ngarkesave të përdorimit, p.sh. Konsulencë për vlerësimin e nëntokës dhe punimeve të themeleve;
- Llogaritja e auditueshme e përkohshme për elementet kryesorë mbajtës,
- Llogaritja e auditueshme e përkohshme për themelet.

2.7.3 Projekt idea përfundimtare

- Llogaritja e avancuar dhe e auditueshme për elementet kryesorë mbajtës, në

formë të përshtatshme për zbatim;

- Llogaritja e avancuar dhe e auditueshme për themelet, në formë të përshtatshme për zbatim;
- Shpenzimi shtesë për teknika ose dizajne ndërtimi të veçanta (p.sh. Qartësimi i detajeve të projektimit);
- Llogaritja e avancuar për sasi të çelikut dhe drurit, që nevojiten për strukturat mbajtëse dhe lidhjet e transmetimit të forcave (kapriatat) për të lejuar procesin e tenderimit pa dokumentacionin e zbatimit;
- Testet për sigurinë ndaj tërmetit.

2.7.4 Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Teste fizike të ndërtesës për rezistencën ndaj zjarrit;
- Llogaritja statike dhe paraqitja grafike e masave të mbrojtjes kundër rrëshqitjes së tokës dhe gjendjes së ndërtesës, në rastet ku këto shërbime shkojnë përtej standardeve të ndërtimit;
- Vizatime që saktësojnë pozicionet statike/ dinamike dhe përmasat strukturore, përforcimin e nyjeve, ngarkesat e trafikut, llojin dhe cilësinë e materialeve, dhe çdo veçori të pazakontë të projektimit që dorëzohet për testimin zyrtar në planet e pozicionit;
- Përgatitja e llogaritjeve sipas klasave të ngarkesave;
- Regjistrimi i gjendjes së ndërtimit, në rastin e punimeve inxhinierike ku sistemi statik/ dinamik devijon nga varianti përfundimtar.

2.7.5 Projekti i zbatimit

- Vizatime të detajuara nga ofruesit për punimet e çelikut ose të drurit, përfshirë këtu dhe listën e pjesëve të veçanta, vizatime të elementeve të parafabrikuar me betonarme duke përfshirë çelikun dhe pjesët e veçanta;
- Llogaritja e lëvizjes së zgjeruar, specifikimi i procedurave të tensionimit dhe prodhimi i protokolleve të provës së tensionimit për punimet e betonit të paratensionuar;
- Punime madhore që bëhen të detyrueshme si pasojë e ndryshimeve në projekt, që nuk shkaktohen nga ofruesi;
- Vizatime paraprake të ndërtimit për punime betonarmeje, që nuk kërkojnë plotësime me vizatime në vend nga projekti inxhinierik.

2.7.6 Përgatitja e tenderit

- Kontributi në specifikimet e projektit inxhinierik, dhe grafikun e punimeve nga projektuesi i objektit;
- Kontributi, në përgatitjen e përmbledhjes së kostove krahasuese të projektit inxhinierik;
- Përgatitja e një grafiku punimesh për strukturat mbajtëse.

2.7.7 Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit

- Ndihma me kontrollin dhe vlerësimin e tenderit, ofertave sipas specifikimeve të projektit dhe grafikut të punimeve (afateve kohore);
- Ndihma me kontrollin dhe vlerësimin e tenderit, ofertave, sipas procedurave të tenderit;
- Ndihma me vlerësimin e kostove, sipas legjislacionit në fuqi, bazuar në çmimet për njësi ose tenderimi me çmime fikse.

2.7.8 Mbikëqyrja e projektit

- Mbikëqyrja teknike gjatë zbatimit të strukturave mbajtëse, duke kontrolluar përputhshmërinë me dokumentet e miratuara statike;
- Mbikëqyrja teknike e strukturave të përkohshme, si punimet dhe skeleritë e kallëpëve, shinat e vinçave dhe skarpatat e gërmimeve;
- Ndjekja e prodhimit të betonit dhe përpunimi i tij në objekt/kantier në situata të veçanta, si dhe analiza statike të provave të cilësisë;
- Këshillimi inxhinierik mbi betonin.

2.7.9 Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudimi. Kontrolli fizik i projektit për të identifikuar dhe ndjekur faktorët që veprojnë në qëndrueshmëri.

2.7.10 Shërbime të veçanta për shndërrim dhe modernizim Ndihma me mbikëqyrjen e fazave të zbatimit për strukturat mbajtëse.

2.8 Sistemet teknike sipas tipologjisë së shërbimit

Tipologjitë mund të përfshijnë shërbimet e veçanta të mëposhtme:

2.8.1 Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Analiza e sistemeve (sqarime për sistemet e mundshme për sa i përket përfitimeve, shpenzimeve, efektivitetit të kostove, fizibilitetit dhe ndikimit në mjedis);
- Hedhja e të dhënave, analiza dhe proceseve të duhura për kursimin e energjisë dhe metodave të përshtatshmërisë mjedisore.

2.8.2 Projektidea paraprake

- Kryerja e provave dhe e testeve të kontrollit;
- Shqyrtimii rezultateve të ndërtimit dhe sistemit të duhur, për sa i përket konsumit të energjisë dhe çlirimit të ndotësve (p.sh. SO_2NO_x);
- Zhvillimi i strategjive për përmirësimin e konceptit energjetik.

2.8.3 Projektidea përfundimtare

- Përpunimi i të dhënave nga pala e tretë (p.sh. transmetimin e dritës, transmetimin e fuqisë termike, etj.);
- Studimi i hollësishëm i efijencës ekonomike;
- Krahasimi i hollësishëm për çlirimin e ndotësve;
- Përlllogaritja e kostove operacionale;
- Përlllogaritja e çlirimit të ndotësve;
- Përgatitja e pjesëve teknike në katalogu/librit të hapësirave, si pjesë e preventivit dhe planit të punës së projektuesit.

2.8.4 Projekti i zbatimit

- Kontroll dhe pranim i vizatimeve duke filluar nga ato të formave të betonit e deri në ato të strukturave mbajtëse dhe përshtatja e vizatimeve nga kontraktorët, apo ofruesit me vizatimet e tyre dhe projektin në tërësi;
- Përgatitja e vizatimeve për lidhjet e makinerive dhe fadromave nga furnitorët e ndryshëm;
- Përgatitja e diagramave të lidhjeve elektrike.

2.8.5 Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit

- Përgatitja e vizatimeve të tenderit për punimet e specifikuara në preventiv, të shoqëruara me grafikun e punimeve.

2.8.6 Mbikëqyrja

- Zbatimi i provave funksionale dhe atyre të shërbimeve;
- Trajnimi fillestar i operatorëve;
- Mbikëqyrja dhe korrigjimi i detajeve me prodhuesit;
- Përgatitja, përditësimi dhe monitorimi i grafikut të punimeve (sidomos zbatimi i detyrave kritike, nëse këto janë të përcaktuara).

2.8.7 Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar, dhe kolaudimi

- Hartimi i vizatimeve dhe përcaktimi i frekuencës për mirëmbajtjen;
- Mbikëqyrja teknike e konsumit të energjisë dhe i çlirimit të ndotësve.

2.8.8 Shërbime të veçanta për shndërrim destinacioni dhe modernizim

- Zbatim i provave të konsumit të energjisë elektrike;
- Studime endoskopike.

Shtojca 3.

Ref. Nenit 5, Lista e projekteve model

3.1 Ndërtesat

Tipet e mëposhtme të ndërtesave, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i) Grupi I tarifor:

Kazermat e akomodimit të përkohshëm dhe të fjetjes, sallat e lojrave, sallat e pushimit, dhomat e magazinimit, korridoret lidhëse, stallat, barakat dhe ndërtesat e tjera bujqësore të thjeshta, pika të thjeshta vrojtimi, tribunat, konstruksionet për mbrojtjen nga moti.

ii) Grupi II tarifor:

Akomodimet e thjeshta të banimit me kuzhina dhe objekte sanitare të përbashkëta;
Garazhet, parkimet shumëkatëshe, serrat;
Sallat dhe ndërtesat e veçanta një-katëshe, zyrat e biletave;
Shtëpite-varkë, punishte të thjeshta pa shina për vinça;
Magazinat, pikat e trajtimit të aksidenteve dhe për dhënien e ndihmës së shpejtë;
Pavijonet e muzikës dhe eventeve, të përkohshme.

iii) Grupi III tarifor:

Komplekse banesash, banesa dhe hostele me pajisje dhe mobilje mesatare;
Kopshte, çerdhe, strehime komunale, hostelet e të rinjve, shkolla fillore;
Qendra argëtimi për të rinjtë, qendra rinore, hostele, konvikte për studentë, azile apo shtëpi akomodimi për të moshuar, si dhe qendra të tjera të administrimit të ndihmës sociale;
Punishte të prodhimit të metalit, shtypshkronja, fabrika frigoriferike;
Punishte, salla të mbyllura dhe ndërtesa bujqësore, struktura që nuk përfshihen në grupet tarifore I, II, apo IV;
Parkime shumëkatëshe me përdorime të tjera të integruara;
Komplekse zyrash me pajisje dhe mobilje mesatare, fabrika, qendra tregtare, markete dhe tregje, galeri arti, restorante, kantina, mensa studentësh, ndërtesa tregtare, stacione zjarrfikëse, stacionet e ndihmës së shpejtë, klinika, struktura të ndihmës mjekësore, infirmieri pa ndihmë mjekësore të specializuar, ambulanca;
Ekspozita, kinema;
Palestra dhe salla sportive dhe objekte të tjera të papërfshira në grupet tarifore II, ose IV.

iv) Grupi IV tarifor:

Komplekse banesash me pajisje dhe mobilje mbi mesataren, shtëpi të tarracuara dhe shtëpi në terrene të pjerrëta, vila me kërkesa projektuese të mëdha të përfshira në grupe shtëpish, komplekse me densitet të lartë ndërtimi, hostele me struktura mjekësore;

Fabrika për prodhim birre, fabrika të montimit të automobilëve, stacione të energjisë elektrike;

Shkolla (me përjashtim të shkollave fillore), qendra edukative, duke përfshirë ato për edukimin pas-shkollor, kolegjet teknike, politeknike, universitetet, akademitë, sallat e leksioneve, laboratore, librari dhe arkiva, institute edukative dhe kërkimore, objektet e përfshira në grupin V tarifor;

Ndërtesat bujqësore me pajisje dhe instalime mbi mesataren, kuzhinat e kateringut, hotele, banka, qendra unike komerciale, bashki, parlamente, gjykata dhe ndërtesa të tjera administrative me pajisje dhe mobilime mbi mesataren;

Spitale të kategorisë I dhe II, spitale të specializuara dhe me qëllime të veçanta, objekte terapeutike dhe ato të rehabilitimit fizik, shtëpi konvaleshence, SPA dhe objekte të tjera të kësaj natyre;

Kisha, xhami, teqe dhe objekte të tjera të kësaj natyre; sallone koncertesh, muzeume, studio teatrale, sallone fetare që ofrojnë dhe përdorime të tjera të natyrës kulturore dhe sportive;

Pishina, qendra sportive dhe stadiume.

v) Grupi V tarifor:

Kategori e lartë e spitaleve, klinika universitare;

Ndërtesa të punimeve të çelikut, të qymyrit koks, uzinat e shkrirjes;

Studio radiosho, televizioni dhe teatri, holl koncertesh, auditore, ndërtesa për kërkime shkencore apo eksperimentale.

3.2 Struktura në ambient të hapur

Strukturat në ambient të hapur të mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i) Grupi I tarifor:

Modelim i peisazhit duke mbjellë bimësi;

Gjelbërim për mbrojtjen nga era;

Lëndina për të luajtur, të mbjella me bar, kodra dhe zona për ski pa sisteme teknike.

ii) Grupi II tarifor:

Sipërfaqe të hapura me konstruksione të thjeshta në lagje të vogla, ndërtesa individuale dhe struktura bujqësore;

Zona të gjelbra përkrah rrugëve, përveç atyre që përmenden në grupet tarifore

I ose III, zona të gjelbra lidhëse pa ndonjë strukturë të veçantë, fusha sportive, zona për ski me struktura të veçanta, fusha sportive pa shtigje të destinuara për vrap apo me struktura të tjera të veçanta;

Gjelbërim për rehabilitimin e landfilleve, venddepozitimeve të mbetjeve dhe guroreve;

Zona të mbjella rurale përveç atyre që mbulohen nga grupi tarifor I, breza të ngushtë të gjelbër midis zonave urbane.

iii) Grupi III tarifor:

Sipërfaqe të hapura pranë ndërtesave private dhe publike të papërmendura në grupet tarifore II, IV, ose V;

Zona të gjelbra përkrah rrugëve, me kërkesa shtesë për sa i përket sigurisë, konservimit dhe zhvillimit natyror apo të peizazhit;

Zona me specie dhe habitate të mbrojtura, që nuk përmenden në grupet tarifore IV apo V;

Varrezat e dëshmorëve, monumentale dhe historike, fusha loje me shumë qellime dhe objekte të tjera sportive të papërfshira në grupet tarifore II ose IV;

Vende kampingu, tendash dhe pishina, komplekse kopshtarie në periferi të qytetit për përdorim privat.

iv) Grupi IV tarifor:

Sipërfaqe të hapura me topografi dhe kushte hapësinore të veçanta, në struktura private apo publike;

Rripa të gjerë të gjelbër midis zonave urbane, zona të rregulluara dhe të gjelbëruara për këmbësorë, çati të gjelbra me densitet të ulët;

Zona me habitat të mbrojtur me kërkesa të veçanta apo funksione të veçanta habitati;

Objekte sportive, fusha loje/sportive, stadione, pishina të hapura, fusha golfi, varreza publike/private, parqe, teatro të hapur (amfiteatër), kopshte të gjelbra shkollorë, shtigje dhe zona për soditje pejsazhi.

v) Grupi V tarifor:

Kopshte shtëpiake private dhe kopshte varrezash, që kanë standarte të larta pamore, tarraca, çati të gjelbra dhe çati të gjelbra me densitet të lartë, zona të hapura të lidhura me zona historike, parqe historike, kopshte dhe sheshe; kopshte botanike dhe zoologjike, sipërfaqe të hapura që kanë kërkesa të veçanta, kopshte ekspozitive.

3.3 Punime për ndarjet funksionale të brendshme

Punimet për ndarjet funksionale të brendshme të mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i) Grupi I tarifor

Rrugëkalimet e brendshme, salla të brendshme me përdorime relaksi apo argëtimi, hapësira të brendshme tejet të thjeshta, për përdorim të përkohshëm

ii) Grupi II tarifor:

Dhoma të thjeshta banimi, dhoma të përbashkëta, ambiente zyrash, punishte, salla të shitjes me shumicë, dhomat ndihmëse brenda strukturave sportive, kioska të thjeshta shitjeje;

Ambiente të brendshme të mobiluara me mobilje dhe pajisje të prodhuara në masë;

iii) Grupi III tarifor:

Dhoma të përbashkëta, restorante, struktura të relaksit, dhoma të vogla konferencash, ambiente rezidenciale, hapësira sociale, zona mbledhjesh dhe salla shitjesh, kantina dhe dhoma hoteli, dhoma spitali, klasat, banjat me pajisje me nivel teknik mesatar; Stenda ekspozimi që përdorin sisteme modulare;

Dhoma të brendshme me kërkesa mesatare dizenjimi dhe të mobiluara me mobilje të prodhuara në masë dhe instalime të thjeshta.

iv) Grupi IV tarifor:

Dhoma rezidenciale, dhoma të përbashkëta, dhoma trajtimi, dhoma shitjeje, zyra, zona të brendshme në biblioteka, dhoma takimi, dhoma sociale, restorante, salla leksionesh, auditore, ekspozita dhe stenda ekspozitash me objekte të veçanta që nuk mbulohen nga grupet tarifore II apo III;

Holle recepsioni, zona të banakut me kualitet të lartë, pajisje me cilësi të lartë dhe objekte teknike mbi mesataren, si në spitale, hotele, banka, qendra tregtare, ose bashki;

Parlamente dhe gjykata, holle fetare, kulturore, apo sportive;

Punime të ndarjeve funksionale të brendshme në pishina dhe kuzhina komerciale;

Kisha, xhami, teqe, apo objekte kulti të kësaj natyre;

Dhoma të brendshme me kërkesa të larta dizenjimi me disa mobilje të prodhuara në masë dhe me instalime teknike të nivelit të lartë.

v) Grupi V tarifor:

Auditoriume koncertesh dhe teatrale, radio, TV, dhe studio teatri;

Dhoma biznesi dhe takimesh me cilësi shumë të lartë, me pajisje të shtrenjta dhe sisteme teknike të nivelit shumë të lartë;

Dhoma të brendshme ose zona prezantimi me cilësi shumë të lartë, me mobilim shumë cilësor ose kërkesa teknike të veçanta.

3.4 Veprat inxhinierike

Veprat inxhinierike të mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i) Grupi I tarifor:

Çisterna, tubacione të ujit pa pika kontrolli;

Tubacionet e ujërave të zeza pa pika kontrolli;

Rrjedha ujore uniforme pa pika kontrolli, me përjashtim të rrjedhave ujore me elemente kryesisht ekologjike dhe të peizazhit;

Basene deri në 3 m lartësi të digës së sipërme, pa sistem lehtësimi për përmytjet, përjashtuar pellgjet pa diga, vendet e ankorimit për varka në ujëra jo të rrjedhshme (liqene); prita dhe diga të thjeshta; punime tokësore të thjeshta, por veçanërisht të mëdha në dimensione, me përjashtim të punimeve të dheut dhe atyre të peizazheve, Tubacione për lëngje apo gazra që ndotin ujin, pa pika kontrolli, objekte standarde parafabrikate për rezervuare;

- Depozitime, pikat e grumbullimit dhe stacionet e transferimit të mbetjeve urbane ose materiale të riciklueshme, pa struktura të tjera shtesë;
- Shtigje kalimi dhe shërbimet e nevojshme me prerje të thjeshta dhe skarpata për projektimin e peizazhit, përveç atyre që nuk kërkojnë shërbimet e përcaktuara në Kreun IV;
- Skarpatat e lumenjve, instalimet për izolimin e zhurmave, përveç atyre për peizazhet, strukturat mbajtëse dhe punimet e tokës, përveç ato që përshkruhen në Nenin 40, paragrafi 2, pikat iii)-v);
- Punime të thjeshta tulle për oxhaqe, kulla të thjeshta pa superstruktura, struktura shumë të thjeshta të furnizimit dhe tuba për veshje, pa pika kufizimi.

ii) Grupi II tarifor:

Sisteme të thjeshta për nxjerrjen dhe furnizimin me ujë, si: puse, burime ujore, rezervuare të thjeshtë, kontenierë në struktura të parafabrikuara, sisteme të shuarjes së zjarrit;

Linjat e furnizimit me ujë, me lidhje minimale dhe pika të pakta kontrolli, rrjet të thjeshtë të ujit të pijshëm;

Punime të trajtimit të ujit industrial, të depozitave apo punishteve të ujit të ndotur, zona filtrimi, basenet mbledhëse të ujit të shiut, tubacionet e ujërave të zeza me degëzime minimale dhe pak pika kontrolli, rrjete të thjeshta të ujërave të zeza;

Objektet të thjeshta të pompimit, punishte pompimi dhe makineritë e ujit;

Argjinatura të thjeshta, kanale dhe pika të pakta kontrolli, rrjedha ujore të thjeshta dhe në formë të njëtrajtëshme me pak pika kontrolli;

Basene me mbi 3 m lartësi të digës, pa sistem kundra përmytjes, basene me më pak se 3 m lartësi të digës, me sistem kundra përmytjes;

Argjinatura të rrjedhave, vendparkim i thjeshtë i varkave, pika shkarkimi dhe ngarkimi, parkim barkash në ujë të rrjedhshëm, punime digash dhe molesh që nuk përmenden në grupet tarifore I, III, ose IV;

Sisteme vadiqe pa tubacione, punime të mëdha toke me një gamë të caktuar lartësish së hedhjes së materialeve;

Tubacione për lengje dhe gazra që ndotin ujin me pak pika lidhjeje dhe kontrolli, sisteme industriale të parafabrikuara me ndarje një fazore të lëngjeve;

Venddepozitime të përkohshme, pika grumbullimi dhe stacionet e transferimit të mbetjeve urbane ose materialeve të riciklueshme dhe sistemet e seleksionimit të mbetjeve të riciklueshme, sisteme të mbetjeve nga ndërtimi;

Venddepozitime të mbetjeve të ngurta, sisteme të mbetjeve të dekompozueshme.

Ura të drejta dhe njëkalimshe, prerje të papërfshira në grupin tarifor I;

Struktura mbajtëse për ngarkesa të levizshme;

Mure të thjeshta të moleve dhe pistave në ujë, argjinatura dhe muret e lumenjve të papërmendura në grupet tarifore I ose III;

Struktura të thjeshta të mbrojtjes nga zhurmat, që nuk kërkojnë shërbimin e përcaktuar në Kreun 4 seksionin I;

Oxhaqe të thjeshta të papërmendura në grupin tarifor I;

Direkë dhe kulla pa superstruktura të papërmendura në grupin tarifor I, struktura të funizimit dhe të tubave veshës, të lidhur me akse për sistemet e furnizimit dhe pak pika kontrolli;

Sillose të vendosura në mënyrë horizontale pa objekte të tjera;

Skela, doke dhe hekurudha të thjeshta.

iii) Grupi III tarifor:

Puse të thellë, pajisje depozitimi;

Impiante të kondicionimit të ujit të thjeshta, me fadroma dhe sisteme me procese mekanike;

Tubacione për ujë me lidhje të shumta dhe pika të shumta kontrolli, rrjete ujore me lidhje të shumta e pika të shumta kontrolli, si dhe një zonë presioni;

Punime për trajtimet e ujërave të zeza me stabilizim aerob (nga ajrosja e njëtrajtshme substancat organike të baltës fundore transformohen në humus dhe në produkte minerale), pika depozitimi të ujit të ndotur me sisteme mekanike;

Tubacione të ujërave të zeza dhe pika të shumta lidhjeje dhe kontrolli;

Rrjete të ujërave të zeza me pika të shumta lidhjeje dhe kontrolli;

Sisteme pompimi dhe makineri ujore të papërfshira në grupet tarifore II ose IV;

Stacione të vogla të prodhimit të hidroenergjisë, diga fikse të papërmendura në grupin tarifor II;

Diga të thjeshta të lëvizshme, kanale të papërmendura në grupet tarifore II ose IV;

Rrjedha të vetme, jo uniforme dhe të pandara, me pak pika kontrolli, sisteme rrjedhjesh me pak pika kontrolli;

Basene për kontrollin e përmytjeve, me lartësi dige më pak se 5 m dhe kapacitet deri në 100,000 m³, kanale të lundrueshme, vendparkime anijesh, pika të zbarkimit dhe ngarkimit;

Porte dhe punime të vështira të digave dhe moleve;

Diga portesh, vepra të thjeshta portesh, portat e digës, basene të mbledhjes së ujit të shiut dhe kanaleve me disa lidhje dhe disa pika kontrolli, sisteme të drenazhimit të ujërave të shiut;

Tubacione për lëngje dhe gazra që ndotin ujin, me pak pika lidhjeje dhe kontrolli, sisteme për depozitimin e lëngjeve që nuk duhet të përzihen me ujë, qendra pompimi për çisterna betoni, sisteme me një shkallë ndarje për ndarjen e lëngjeve të lehta, që nuk janë të përfshira në grupin tarifor II, rrjete tubash bosh me pak lidhje;
 Venddepozitime mbetjesh të përkohshme, pika grumbullimi dhe rekuperimi të materialeve të papërmendura në grupet tarifore I ose II;
 Impiante të përpunimit të mbetjeve të papërfshira në grupet tarifore II ose IV;
 Impiante të përpunimit të materialeve të mbetura nga ndërtimi, të papërmendura në grupin tarifor II;
 Impiante të kompostimit të mbetjeve të biodegradueshme;
 Impiante të kompostimit të mbetjeve, të papërmendura në grupin tarifor IV, mbyllja e vendeve të ndotura të papërmendura në grupin tarifor IV;
 Ura njëkalimshe, të papërmendura në grupin tarifor II ose IV;
 Ura disakalimshe dhe të harkuara, strukturat ngarkesëmbajtëse me ankorim, muret e moleve dhe të pistave, të papërmendura në grupin tarifor II ose IV;
 Mure nëntokësore me pilota dhe rrjete, mure me pilota të thella, argjinatura dhe mure lumenjsh komplekse;
 Objekte të thjeshta për mbrojtje nga zhurmat, që nuk përmenden në grupet tarifore II ose IV, por që kërkojnë shërbime, sikurse është përcaktuar në Kreun 4, seksionin I;
 Tunele të thjeshta dhe punime shpimesh;
 Oxhaqe me kompleksitet mesatar, kulla me superstruktura, kulla të thjeshta ajrimi/ftohjeje;
 Struktura furnizuese, për sisteme furnizimi në situata të veçanta, sillos me objekte ndihmëse të thjeshta;
 Porte dhe vendndisje anijesh/ varkash, të papërfshira në grupin tarifor II ose IV;
 Vende ankoruese të thjeshta dhe garazhe nëntokësore të veçuara;
 Punime të thjeshta kullash apo gërmimesh, punime të thjeshta shpimi, ndërtime komplekse për instalimet e ngrohjes qendrore, ndërtime të komplikuar betoni për sisteme ngrohje, stacione treni/tramvaji, të thjeshta nëntokësore.

iv) Grupi IV tarifor:

Shpime/galeri për puse nëntokësore dhe horizontale, çisterna depozitimi në formë kullash;
 Sisteme të përpunimit të ujit, me procese fizike dhe kimike, sisteme të thjeshta për dekontaminimin e ujërave nëntokësore, rrjete tubacionesh për ujë, me lidhje dhe kontrolle të shumta;
 Sisteme për trajtimin e ujërave të zeza, që nuk përmenden në grupet tarifore III ose V;
 Sisteme për trajtimin e baltave; rrjete tubacioni të ujërave të zeza, me lidhje dhe pika kontrolli të shumta; sisteme komplekse të pompimit dhe makinerive ujore;
 Objekte për rritjen e presionit, stacione hidro-energji dhe diga të lëvizshme, që nuk përmenden në grupin tarifor III;
 Kanale rrugore me disa qëllime, rrjedha jo-uniforme me shumë pika kontrolli, sisteme rrjedhash me shumë pika kontrolli, rrjedha veçanërisht të vështira, me kritere të larta teknike dhe metoda të kompesimit ekologjik; basene për kontrollin e përmblyjeve dhe prita për kapacitete ujore nga 100,000 m³ and 5,000,000 m³;

Vendi i ankorimit të anijeve, pika të ngarkim shkarkimit, subjekt i baticave ose veprimtarive përmblytëse, vendparkime anijesh, porte subjekt i baticave ose veprimtarive përmblytëse; punime veçanërisht të vështira për diga dhe prita, prita të papërmendura në grupin tarifor III, basene për mbledhjen e ujërave të shirave të papërmendura në grupin tarifor III; kanale dhe basene me pika të shumta lidhjesh dhe kontrolli;

Sisteme të mbledhjes së ujërave të shiut të kombinuar, sisteme të renda vaditje dhe drenazhimi, në toke heterogjene dhe në terren të vështirë;

Tubacione për lëngje dhe gazra të rrezikuara nga uji, me lidhje dhe kontrole të shumta, sisteme me shumë faza për ndarjen e lëngjeve të lehta, rrjete tubacionesh bosh me lidhje të shumta;

Sisteme të riciklimit dhe përpunimit të mbetjeve multi-fazore, sisteme kompostimi; Sisteme të përpunimit të mbetjeve të veçanta dhe mbetjeve urbane me kushte teknike të vështira, venddepozitime nëntokësore të mbetjeve, depozita mbetjesh, hermetizimi i gropave të vjetra dhe vendeve të kontaminuara, me kushte teknike të vështira, sistemet e trajtimit të tokës së kontaminuar;

Ura komplekse, një apo disakalimshe dhe të harkuara;

Mole dhe pista në ujë të një natyre komplekse;

Objekte për mbrojtjen nga zhurmat në vendndodhje të komplikuar, që nuk kërkojnë shërbimet e përcaktuara në Kreun 4, seksionin I, tunelet e thjeshta dhe punime gërmimesh horizontale;

Oxhaqe komplekse;

Kulla me superstruktura dhe platforma operimi;

Kulla ftohje/ventilimi të papërmendura në grupet tarifore III apo V;

Kanale furnizimi me gropa për disa tubacione të ndryshme, që ndërtohen në kushte të vështira;

Kulla me blloqe modulare dhe objekte ndihmëse, skela detare të vështira, vende për daljen e varkave dhe objekte skelash të thata, vende ankorimi të vështira, garazhe të vështira të papërmendura në grupin tarifor III, gërmime horizontale, vertikale dhe nëntokësore të vështira të papërmendura në grupin tarifor V.

v) Grupi V Tarifor:

Struktura dhe objekte për proceset me disa faza të përpunimit të ujit, sisteme komplekse të dizinfektimit të ujit;

Punime komplekse të trajtimit të ujërave të zeza, struktura dhe objekte për trajtimin me shumë faza të llumrave;

Stacione hidrocentrale komplekse psh stacione pompimi ose gropa nëntokësore, objekte për ngritjen e anijeve;

Basene të kontrollit të përmblytjeve ose barikada për kapacitete me më shumë se 5,000,000 m³;

Impiante inçenerimi, impiante dekompozimi;

Ura dhe tunele, veçanërisht të vështira;

Oxhaqe veçanërisht komplekse;

Kulla me ndërtesa sipër tyre, struktura dhe objekte publike të larta, kulla ftohjeje të vështira, kulla dhe gjurmime veçanërisht të vështira, stacione nëntokësore lidhëse, objekte në det të hapur.

3.5 Struktura transporti

Strukturat e mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i) Grupi I tarifor:

Shtigjet në nivel apo terren të lehtë kodrinor, me kushte të thjeshta kullimi, me përjashtim të rrugëve të pa përshtatshme për trafikun e rregullt të makinave me kushte të thjeshta kullimi, edhe shtigjet e tjera dhe sipërfaqet e asfaltuara të destinuara sipas projektimit në ambient të hapur dhe që nuk kërkojnë shërbime shtesë sikurse është përcaktuar në Kreun III, Seksionin III;

Sipërfaqe për parkime të hapura;

Platforma dhe binarë trenësh pa devijime dhe kryqëzime, të papërmendura në grupet tarifore II-V.

ii) Grupi II tarifor:

Shtigjet në nivel apo terren të lehtë kodrinor, në struktura të thjeshta toke dhe kullimi, me përjashtim të rrugëve të papërshtatshme për trafik të rregullt automjetesh me kushte të thjeshta kullimi, si dhe shtigjet dhe sipërfaqet e asfaltuara të destinuara sipas projektimit në ambient të hapur dhe nuk kërkojnë shërbime, sikurse përcaktohet në Kreun III, Seksionin III;

Rrugë rurale pa pika të veçanta kontrolli, ose mbi terrene të lehta kodrinore, karburante dhe objekte të thjeshta vendpushimi, rrugë kryesore dhe sekondare për lagjet e banimit, parkimet brenda zonave të banuara, nyje të thjeshta të trafikut; Sisteme shinash pa pika kontrolli të veçanta, sisteme shinash në segmentet e hapura dhe me topografi pak të lëvizshme, platforma dhe shina në stacione treni me sisteme të thjeshta levizje; Pista të thjeshta për uljen e avionëve dhe pikë nisje për aeronautikë.

iii) Grupi III tarifor:

Shtigjet në terren të vështirë kodrinor në struktura dhe kullim të vështirë, rrugë rurale me pika të veçanta kontrolli ose mbi terrene kodrinore, karburante dhe objekte vendpushimi të një natyre të vështirë, rrugë urbane dhe sheshe të papërmendura në grupet tarifore II, IV, dhe V;

Zona të kontrollit të trafikut me përjashtim të projektimit të sipërfaqeve të lira dhe gjelbërimit për zonat këmbësore.

Kryqëzimet në një nivel, të thjeshta dhe në disa nivele, zonat me trafik dhe ato me trafik kamionësh;

Hekurudha urbane të papërmendura në grupin tarifor IV;
Hekurudha në zona rurale pa kushte të veçanta;
Hekurudha në zona rurale në terren kodrinor;
Hekurudha dhe platforma me shina, në plane lëvizje të komplikuar;
Zona me trafik të vështirë dhe të lehtë për aeroportet.

iv) Grupi IV tarifor:

Rrugë ekstraurbane, me numër të madh kryqëzimesh, ose me terren kodrinor të papërmendur në grupin tarifor V;
Rrugë dhe sheshe urbane me kërkesa të larta të trafikut, ose në kushte urbane të vështira, si dhe zona me trafik të qetë, të krahaseshme në kompleksitet, përveç projektimit të sipërfaqeve të lira dhe gjelbërimit të zonave këmbësore ;
Nyje trafiku tejet të vështira, në të njëjtin nivel dhe nyje trafiku të vështira në nivele të ndryshme;
Sipërfaqe trafiku për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave në trafik të kombinuar;
Sisteme shinash të vështira në zona urbane, sisteme shinash në zona ekstra urbane me numër të madh pikash kontrolli, sisteme shinash në zona ekstra urbane me topografi shumë të lëvizshme, sisteme shinash dhe platformash në stacione me plane trafiku shumë të vështira;
Pista të vështira për aeroportet.

v) Grupi V tarifor:

Rrugë në zona malore të vështira, rrugë dhe sheshe të vështira urbane me trafik dhe kërkesa teknike shumë të larta, ose në kushte ndërtimi shumë të vështira;
Nyje trafiku shumë të vështira në nivele të ndryshme;
Sisteme shinash interurbane shumë të vështira.

3.6 Struktura të sistemeve teknike

Strukturat e mëposhtme, zakonisht i caktohen grupeve tarifore si vijon:

i) Grupi I tarifor:

Sisteme për gazin, ujin, ujërat e zeza me rrjete të shkurtra dhe të thjeshta;
Sisteme ngrohje me pajisje me djegie të drejtpërdrejtë dhe sisteme të thjeshta të ngrohjes qendrore, pa kërkesa të veçanta në kontroll, sisteme ajrosje të thjeshta;
Struktura telekomunikacioni të thjeshta dhe me voltazh të ulët;
Sisteme me kanale të brendshme të thjeshta për hedhjen e mbeturinave ose pastrimin e rrobave, sisteme magazinimi të larta, të papërmendura në grupet tarifore II ose III;
Strukturat e pastrimit kimik;
Sisteme dhe fabrika mjekësore dhe laboratorike për pajisje elektro-mjekësore, dentare, të mekanikës mjekësore, optike, si dhe për pajisje për klinika të mjekësisë së përgjithshme.

ii) Grupi II tarifor:

Struktura për gazin, ujin, ujërat e zeza me rrjete komplekse tubacionesh, me ashensor dhe me presion, me alarme manuale kundra zjarrit;
Sisteme të ngrohjes qendrore, me kërkesa të veçanta të rregullimit/kontrollit, sisteme të ajrosjes me kërkesa të larta në akustikë, pa korrente ajri dhe me kërkesa për trajtimin e ajrit (përveç ftohjes së ajrit të rregulluar automatikisht);
Struktura kompakte, me voltazh të ulët dhe objekte shpërndarje të papërmendura në grupet tarifore I ose III, instalimet e telekomunikacionit dhe rrjetet e tyre, si: sistemet e thirrjes, të alarmit, sistemet e ndriçimit bazuar në metodën e përlllogaritjes së efikasitetit, instalimet për mbrojtjen nga rrufeja;
Platforma peshëngritëse, vinça të kontrolluar nga toka;
Sistemet e raft-magazinit, lëvizëse, modulare dhe sistemet e transportuesve me shirit lëvizës me deri në dy stacione marrje-dhënie, ashensorët e vështirë të pavarur, grupe ashensorësh të thjeshtë, pa kërkesa të veçanta, sisteme teknike peshëngritëse;
Kuzhina dhe lavanderi në madhësi mesatare;
Sisteme dhe fabrika mjekësore dhe laboratorike për pajisje elektro-mjekësore, dentare, të mekanikës mjekësore, optike, si dhe sisteme nukleare dhe radiografike me rrezatim të vogël, për mjek të specializuar ose grupe klinikash, sanatoriume, shtëpi të moshuarish, si dhe pavione të thjeshta spitalësh;
Struktura laboratorike për shkollë dhe laboratorë fotografikë.

iii) Grupi III tarifor:

Sisteme të prodhimit të gazit dhe stacione për rregullimin e presionit të gazit, duke përfshirë rrjetin e tubacioneve, sisteme për pastrimin dhe detoksifikimin dhe neutralizimin e ujërave të ndotura, sisteme për trajtimin fizik, biologjik dhe kimik të ujit, impiante uji për ujëra të zeza dhe kushte higjienike mbi mesataren, sisteme të automatizuara të fikjes dhe alarmit kundra zjarrit;
Impiante të avullit, impiante të ujit të nxehtë, sisteme të vështira të ngrohjes qendrore bazuar në teknologji të reja, sistemet e ngrohjes me pompë, ato të ngrohjes dhe ventilimit në distancë, fabrikat frigoriferike, fabrikat e ventilimit dhe ftohjes së rregulluar dhe sisteme me ajër të kondicionuar, që përfshijnë dhe fabrikat frigoriferike;
Instalimet me voltazh të lartë dhe të mesëm, qendra të kontrollit të voltazhit të ulët, fabrika private të prodhimit dhe transformimit të energjisë, objektet e shpërndarjes me furnizim voltazhi të ulët dhe për llogaritje të qarkut të shkurtër, sisteme të lehta bazuar në metodën e përlllogaritjes pikë për pikë, sisteme të mëdha të telekomunikacionit dhe rrjeteve të tyre;
Grupime ashensorësh me kërkesa të veçanta, sisteme të kontrolluara transportuese shirit me më shumë se dy qendra marrje dhe dhënie, makineri për furnizimin e rafteve me sistemet e tyre, sisteme qendrore për eliminimin e rrobave, mbetjeve, ose pluhurit, sisteme teknike për skenë të mëdha, dysheme të levizshme dhe sistem për krijimin e dallgëve në pishina, sisteme automatike të mbrojtjes nga dielli;
Kuzhina dhe lavanderi të mëdha;
Instalime mjekësore dhe laboratorike për spitale të mëdha, me dhoma trajtimi dhe ekzaminimi të specializuar, për klinika dhe institute me funksione mësimore dhe kërkimore, dhoma për kontrollimin e klimës me pajisjet përkatëse, dhoma të posaçme me temperaturë të kontrolluar dhe pa pluhur, sisteme për pasurimin ose eliminimin e substancave të veçanta, ndërmarrje të mëdha të sektorit kimik, qendra kërkimore dhe zhvillimore dhe qendra prodhimi dhe mësimi, klinika.

Shtojca 4.

Ref.Nenit 18:

Planifikimi i përgjithshëm vendor sipas fazave (niveli vendor dhe më lart)

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza I	Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse	1%-5%
2	Faza II	Përgatitja e analizës së thelluar	10%-20%
3	Faza III	Hartimi i planit paraprak	30%
4	Faza IV	Hartimi i planit përfundimtar	25%
5	Faza V	Hartimi i rregullores	15%
6	Faza VI	Projekti përfundimtar për miratim	5%

Tabela. 8. Tabela e përqindjes së tarifimit sipas fazave të shërbimit të planifikimit të territorit

Shpjegim: Kur nisma për fillimin e PPV-së hartohet për herë të parë, atëherë kjo fazë duhet të llogaritet 5%, në rast se kryhet rishikimi i nismës për fillimin e PPV-së, kjo fazë duhet të llogaritet me 1%-3%.

Edhe për fazën e dytë do të ndiqet po e njëjta logjikë si më lart, për rastet e hartimit të nismës për fillimin e PPV-së për herë të parë, përgatitja e analizës së thelluar do të llogaritet me 20%, kurse në rastin kur kryhet rishikimi i hartimit të nismës për fillimin e PPV-së, përgatitja e analizës së thelluar do të llogaritet me 10%-15%.

4.1 Faza I e shërbimit: Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse (1-5 %)

- Përcaktimi i kufijve të saktë të Njësisë së Qeverisjes Vendore në hartë sipas këkesave ligjore;
- Identifikimi me dokumente dhe vendosja në hartë, i çështjeve, zonave dhe/ose objekteve të rëndësisë kombëtare, të shoqëruar me një raport përmbledhës mbi implikimet e tyre në territorin nën juridiksionin e NJ.Q.V.;
- Studimi, i cili përcakton nevojat e hartimit të planit ose rishikimit të tij për territorin e NJ.Q.V.;
- Hartimi i planit të veprimit, së bashku me përmbledhjen e dokumenteve dhe pjesët përbërëse të planit të territorit, ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës, përcaktimi i termave të referencës për planin e përgjithshëm vendor, përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike dhe afatet përkatëse;
- Parashikimi i buxhetit për hartimin e planit të territorit.

4.2 Faza II e shërbimit: Përgatitja e analizës së thelluar (10-20 %)

- Analiza e dokumenteve të planifikimit ku përfshihen analizë të dokumenteve kombëtare dhe/ose rajonale, analizë e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë mbi territorin duke përfshirë vlerësimin e tyre dhe implikimet për planin e ri;
- Analiza e thelluar e elementeve ekzistues të territorit mbi topografinë, studimin gjeologjik të zonës, studimin e hidrografisë, studimin e aktiviteteve sizmike (makrozonim dhe mikrozonim);
- Analiza e zonave bujqësore dhe natyrore ku përfshihet; por nuk kufizohet boniteti i tokave, gjendja ekzistuese e tokës bujqësore, potenciali ekonomik i tokës bujqësore, mjedise pyjore, kullota;
- Analizë e detajuar e burimeve natyrore ku përfshihen, por nuk kufizohet në informacion mbi sipërfaqet ujore, rezervate, miniera;
- Analiza e detajuar e elementeve të trashëgimisë kulturore, identitetit historik të zonës, zonat e mbrojtura natyrore. Vlerësimi i potencialeve dhe kufizimeve të cilat rrjedhin prej tyre;
- Analiza rajonale e NJ.Q.V., ku saktësohet pozicionimi strategjik i saj në rajon.
- Analiza dhe vlerësimi ekonomik dhe social, ku përfshihen analiza e kapitalit social të zonës, punësimi, edukimi, profili ekonomik, konkurrueshmëria, pozicionimi i aktiviteteve ekonomike dhe poleve ekonomike, pikat e forta dhe të dobëta për zhvillimin e ardhshëm të zonës;
- Analiza dhe vlerësimi demografik, ku të përfshihen analiza e shpërndarjes së popullsisë në territor, projeksionet e popullsisë për vitet e ardhshme, analiza e demografike e lëvizjeve mekanike dhe natyrore të popullsisë në vite;

- Analiza e pronësisë, ku përfshihen analiza e përdorimit të pronave publike, raporti pronë publike/pronë private, konfliktet e pronësisë dhe situata e infomalitetit në territor;
- Analiza e problematikës mjedisore, burimet ndotëse dhe të dhëna për efektin e tyre në territor, trashëgimi kulturore dhe shëndetin e njeriut, analiza e menaxhimit të mbetjeve në zonë dhe vlerësimi i situatës ekzistuese;
- Analiza e përdorimit ekzistues të tokës sipas kategorive dhe nënkategorive bazë të përdorimit të tokës, të përcaktuara në aktet nënligjore të planifikimit të territorit;
- Analiza e përgjithshme e kushteve dhe cilësisë fizike, të strukturave dhe territoreve;
- Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese, bazuar në elementet e shpërndarjes dhe pozicionimit në territor, elementeve të njëtrajtshmërisë së formës dhe volumit, përdorimit të tokës;
- Analiza e detajuar e cilësisë së infrastrukturave dhe shërbimeve ku përfshihen, por nuk kufizohen infrastruktura rrugore, telekomunikacionit, energjitikës, shëndetësisë, arsimit, ujit dhe kanalizimeve;
- Analiza e periferalitetit, ku përfshihen, por nuk kufizohen, segregimi social, aksesibiliteti i NJ.Q.V. dhe i zonave të ndryshme brenda NJ.Q.V., niveli i varfërisë sipas zonave, niveli i kriminalitetit, cilësia e hapësirave publike, vlera e tregut të tokës sipas zonave, cilësia dhe shpeshtësia e ofrimit të shërbimeve sipas zonave;
- Analiza e nevojave për strehim për të gjitha grupet shoqërore.

4.3 Faza III e shërbimit: Hartimi i planit paraprak (30 %)

- Përmbledhja e dokumentit strategjik dhe rishikim i drejtimeve/skenarëve bazë për zhvillimin e territorit, ku përfshihen drejtimet ekonomike, urbane dhe ato infrastrukturore;
- Përcaktimi në territor i vizionit strategjik të zhvillimit, ku përfshihen edhe objektivat strategjike për zhvillimin;
- Rishikimi i kuadrit të politikave, në përmbushje të vizionit dhe objektivave strategjike të zhvillimit të territorit dhe shpërndarja e tyre në territor. Shpërndarja në hartë e politikave territoriale;
- Hartimi i hartave që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit, drejtimet kryesore të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve;
- Draft-harta e planit të përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, në bazë të kategorive dhe nënkategorive të tokës, propozimi për ndarjen e njësive strukturore dhe zonat me prioritet zhvillimi, dhe propozime për nyjat infrastrukturore kryesore.

4.4 Faza IV e shërbimit: Hartimi i planit përfundimtar (25 %)

- Hartimi i planit të përdorimit, të tokës dhe të strukturave në të; ku përfshihen kategoritë dhe nënkategoritë bazë të përdorimit të tokës, njësitë strukturore dhe zonat me prioritet zhvillimi, të shoqëruar me indikatorët dhe koeficientët përkatës të zhvillimit të territorit;
- Hartimi i planit të shërbimeve dhe infrastrukturave publike; ku përfshihen por nuk kufizohen përmirësimet e shërbimeve ekzistuese ose hapja e shërbimeve të reja, infrastrukturë rrugore e re ose rikontraksione;
- Hartimi i planit të veprimeve për zbatimin e PPV-së;
- Hartimi i materialit hartografik i PPV-së, i cili shoqëron dhe pasqyron të gjitha pjesët e strukturës së PPV-së. Hartat përgatiten sipas specifikimeve për bazat e të dhënave të përcaktuara në Rregulloren e Regjistrimit;
- Përgatitja e raportit të përpunimit dhe të ndryshimeve në bazën e të dhënave GIS;
- Përgatitja e indikatorëve për monitorimin e implementimit të PPV.

4.5 Faza V e shërbimit: Hartimi i rregullores (15 %)

Përcaktimi i rregulloreve bazë për zhvillimin e territorit ku specifikohen:

- Përkufizimet e termave të përdorura;
- Shpjegimi i kodeve të përdorura për sistemet dhe kategoritë e përdorimit të tokës dhe të sistemit rrugor, sipas ligjit; njësitë strukturore, zonat me prioritet zhvillimi dhe çdo ndarje tjetër territoriale në plan; zonat për plan të detajuar vendor (PDV); kode të tjera sipas rastit;
- Rregullat e përdorimit të tokës sipas planit të përdorimit të tokës në bazë të kategorive dhe nënkategorive bazë;
- Rregullat e zhvillimit të territorit për çdo njësi strukturore, për zona me prioritet zhvillimi, dhe nëndarje të tjera;
- Rregullat e sistemit rrugor dhe transportit;
- Rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore dhe zonave të trashëgimisë kulturore;
- Normat dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm në fuqi, sipas rastit;
- Rregulla arkitektonike, sipas rastit;
- Rregullat e ndërtimit që përgatiten sipas përcaktimeve të rregullores së ndërtimit.

4.6 Faza VI e shërbimit: Projekti përfundimtar për miratim (5 %)

- Përgatitja e materialeve përmbledhëse për prezantimet publike dhe në KKT;
- Përgatitja e planit të investimeve kapitale;
- Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar të PPV, ku përfshihen: relacioni i vizionit dhe dokumentit strategjik, relacioni i planit të përdorimit të tokës, relacioni i rregullores së zhvillimit të territorit, relacioni i investimeve kapitale, materiali kartografik shoqërues i PPV sipas kërkesave ligjore;
- Hedhja në sistemin e regjistrimit të territorit të dokumenteve të PPV dhe të GIS.

Shtojca 5.

Ref. Nenit 19: Planifikimi i detajuar vendor sipas fazave

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I	Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse	2.5%
2	Faza e II	Përgatitja e analizës së thelluar	30%
3	Faza e III	Hartimi i planit paraprak	25%
4	Faza e IV	Hartimi i planit përfundimtar	40%
5	Faza e V	Projekti përfundimtar për miratim	2.5%

5.1 Faza I: Hartimi i Nismës për PDV (2.5 %)

- Raporti përmbledhës, i cili identifikon zonën dhe analizon parashikimet e PPV në të;
- Përgatitja e dokumentacionit shoqërues, ku përfshihen emri dhe të dhënat e personit, subjektit, ose institucionit që paraqet nismën;
- Studimi, i cili përcakton nevojën dhe qëllimin për të cilin hartohet PDV.

5.2 Faza II: Analiza e Thelluar e Territorit (30 %)

Rilevimi teknik i zonës me anë të hartave në shkallë 1:500 ose 1:1,000, në varësi të sipërfaqes, ku përfshihen topografia, hapësirat, parcelat objektet dhe infrastrukturat. Rilevimi duhet të shoqërohet me dimensionet përkatëse, si dhe me kufirin e saktë të zonës.

- i) Analiza e zonave dhe strukturave të mbrojtura në formë relacioni dhe hartografi:

- Analiza dhe dokumenti i detajuar fotografik të zonës;
- Analiza e detajuar e problemeve mjedisore, infrastrukturore dhe peizazhistike të zonës;
- Analiza e cilësisë së objekteve ekzistuese dhe të nevojave për rigjenerim, konservim apo mirëmbajtje;
- Analiza e detajuar e përdorimit të tokës dhe të strukturave në të, në nivel parcele dhe analiza e nevojave për banesa të reja dhe për funksione dhe aktivitete të tjera;
- Analiza e pronësisë në zonë, të shoqëruar me hartën me listën e pronarëve të parcelave dhe objekteve, si dhe të gjitha të dhënat për çdo pronësi pas regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

5.3 Faza III: Plani Paraprak (25 %)

- Draft-relacioni dhe hartat për planin e parashikuar të përdorimit të tokës në nivel parcele dhe parcelat e reja. Përdorimi i tokës paraqitet për kategoritë bazë, nën kategoritë dhe për funksionet dhe aktivitetet sipas shpërndarjes së tyre në parcela dhe në çdo objekt;
- Draft-relacioni dhe hartat për sistemin rrugor dhe të të gjitha hapësirave publike, pas riorganizimit të parcelave përmes ndarjes dhe/ose bashkimit;
- Draft -reksti dhe hartat për planin e parashikuar të të gjitha infrastrukturave të nevojshme kryesore dhe dytësore në zonë, përfshirë parkimin;
- Draft-paraqitja grafike e mënyrave të parashikuara, për të garantuar akses dhe përdorim të barabartë dhe të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat;
- Draft-përcaktimi në hartë dhe argumentimi në tekst i objekteve që do të shemben dhe atyre që do të rigjenerohen dhe/ose restaurohen;
- Draft-paraqitja voluminoze e zhvillimit të parashikuar në zonë.

5.4 Faza IV: Plani i Përfunduar (40 %)

- Plani i parashikuar i të gjitha infrastrukturave të nevojshme, kryesore dhe dytësore në zonë, përfshirë parkimin;
- Mënyrat e parashikuara, për të garantuar akses dhe përdorim të barabartë dhe të pavarur të hapësirave nga të gjithë personat;
- Përcaktimi në hartë dhe argumentimi në tekst të objekteve, që do të shemben dhe atyre, që do të rigjenerohen dhe/ose restaurohen;
- Paraqitja volumetrike e zhvillimit të parashikuar në zonë;
- Paraqitja e detajuar në tekst dhe në hartë e shpërndarjes së intensitetit të ndërtimit dhe i koeficientit të shfrytëzimit të tokës, për çdo parcelë, objekt dhe pronar, si dhe i distancave dhe lartësive të objekteve në përputhje me

rregulloren e zhvillimit;

- Studimet e ndikimit nga zhvillimi dhe të ndikimit në mjedis, sipas rastit;
- Mënyra e zbatimit të instrumenteve të veçanta të kontrollit të zhvillimit, sipas rastit;
- Mënyra e zbatimit të instrumenteve të drejtimit të zhvillimit në përputhje me Ligjin dhe me rregulloren e zhvillimit;
- Studimi paraprak i fizibilitetit, i cili parashikon kostot, shpenzimet dhe përfitimet e të gjitha palëve,
- Fazat e zbatimit të Planit të Detajuar Vendor dhe detyrimet e palëve të interesuara gjatë çdo fazë.

5.5 Faza V: Përgatitja për Miratim (2.5 %)

- Prezantime publike;
- Përgatitja e dokumentacionit për prezantimin e PDV;
- Përgatitja e dokumentacionit për miratimin e PDV, ku përfshihen relacioni i plotë mbi analizën e zonës sipas komponentëve të përcaktuar më sipër, të gjithë elementet hartografike dhe grafikë që shoqërojnë PDV.

Shtojca 6.

Ref. Nenit 21, paragrafi 3:

Përcaktimi i tarifave të shërbimeve në lidhje me Planet e Detajuara Vendore

1. Ndarja në grupet tarifore përcaktohet në bazë të kriterëve të mëposhtme të vlerësimit për kërkesat e projektimit:
 - i) Kushtet topografike dhe situata gjeologjike;
 - ii) Kërkesat mjedisore dhe kërkesat ndaj strukturës urbane, mbrojtja ndaj monumenteve;
 - iii) Përdorimi dhe dendësia;
 - iv) Shkalla e kërkuar e cilësisë për procesin e planifikim/ projektimit;
 - v) Lidhja me infrastrukturen ekzistuese;
 - vi) Mbrojtja e mjedisit dhe kushtet ekologjike.
2. Kur kriteret e vlerësimit i përkasin grupeve tarifore të ndryshme, duke ngritur dyshime mbi grupin tarifor, në të cilin duhet të futet Planifikimi i Detajuar Vendor për territorin, atëherë duhet të bëhet vlerësimi me sistemin e pikëzimit, në bazë të paragrafit 3, më poshtë dhe në varësi të shumës së pikëve, kategorizohet në një nga grupet tarifore më poshtë:
 - i) Grupi I Tarifor : 0-10 pikë;
 - ii) Grupi II Tarifor : 10-20 pikë;
 - iii) Grupi III Tarifor : 21-30 pikë.
3. Gjatë përlogaritjes së grupit tarifor, për hartimin e Planeve të Detajuara Vendore, shkalla e vështirësisë për secilin zë të përshkruar në paragrafin 1, më sipër, duhet të vlerësohet me 1 deri në 5 pikë. Shuma e tyre do të caktojë grupin tarifor, që i përket.

Shtojca 7.

Ref. Nenit 23 dhe Nenit 28, Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë, si dhe strukturat në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit

7.1 Faza I e shërbimit: Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit;
- Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;
- Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;
- Përmbledhja e rezultateve.

7.2 Faza II e shërbimit: Projekt idea paraprahe(përgatitja e projektit dhe ecurisë projektuese)

- Analiza e e bazës material dhe e parimeve;
- Dakordësimi mbi objektivat (kushtet perreth objektivit, konfliktet eventuale per në arritjen e objektivit);
- Përgatitja e një katalogu/liste te planeve, që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);
- Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundshme;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;
- Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në planin e qytetit, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionalë, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjitik (psh koston efektive të energjisë, strategjinë e përdorimit të energjisë dhe përdorimin e burimeve energjitike të rinovueshme) dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjike, proceset dhe kushtet, si dhe barrën imponuese ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmërinë e tyre;
- Negociatat paraprahe me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e probabilitetit të marrjs së lejes së ndërtimit të objektit;
- Në projektimin e ambienteve të jashtme: mbledhja, vlerësimi dhe shpjegimi i të

dhënave në lidhje me strukturën ekologjike dhe në marrëdhënie me elemente si psh. toka, uji, klima, ajri, flora dhe fauna, plus paraqitja e shfrytëzimit të hapësirës dhe përcaktimi i strategjisë me shpjegime informuese vecanërisht në lidhje me peisazhin, përmirësimin e zonës së banuar dhe ndërlidhjet, me bimësinë ekzistuese, mbjellje të reja, duke ndarë zonën e gjelbërimit, trafikun, ujin, zonat e lojrave dhe zonat sportive, gjithashtu qartësimi dhe pranimi i kufirit të projektit dhe harmonizimin me objektet rrethuese;

- Parashikimi i kostove;
- Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprahe të projektit;

7.3 Faza III shërbimit: Projekt-idea përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

- Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi, të alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike (p.sh. efikasitetin e energjisë, përdorimi i burimeve enegjitike të rinovueshme) dhe kërkesat mjedisore ose të zhvillimit të qëndrueshëm duke vënë në përdorim ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, dhe kompletimi i projekt idesë përfundimtare;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt;
- Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera të kësaj natyre, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi;
- Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit psh projekt idesë paraprahe dhe/ose projekt idea përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë të strukturës; Për sipërfaqet e hapuraparaqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, vecanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmerren , masat për mbrojtjen, mirmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit. Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të ndarjes së mureve, ngjyra, drita dhe materiali, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapsinore;
- Negociatat për probabilitetin e lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Parashikim i kostove sipas manuali të çmimeve (MTI) që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose dëshirave kualitative të investitorit.
- Kontrolli i kostove, duke i krahasuar përlogaritjen e kostos me koston paraprahe;
- Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit.

7.4 Faza IV e shërbimit: Projekti për miratimin e lejës së ndërtimit

- Përgatitja e dokumenteve të dorëzimit për miratim dhe lejet e kërkuara, në bazë të rregullores për planifikimin urban, duke përfshirë edhe kërkesat për përjashtime dhe ngrirje/shtyrje kushtesh, duke përdorur ndihmesën e ofruar nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt si edhe ndonjë negociim me autoritet publike;
- Dorëzimi i dokumenteve në entin publik;
- Përfundimi dhe plotësimi nëse është e nevojshme i kërkesës së projektit, përshkrimet dhe shpenzimet duke përdorur ndihmesën e specialistëve të përfshirë në projekt;
- Sistemitet e jashtme dhe punimet e ndërtimit: Kontrollimi i kërkesave dhe lejeve speciale që duhen për miratimin e kërkesës dhe për marrjen e lejes të ndërtimit.

7.5 Faza V e shërbimit: Projekti i zbatimit

- Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4 (zhvillimi dhe paraqitja hap pas hapi e projektit të zgjidhur) duke marrë parasysh planin e qytetit, funksionin, gjëndjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike (psh efikasitetin e energjisë, përdorimi i burimeve energjitike të rinovueshme) dhe kërkesat e mjedisit ose të konservimit duke përdorur edhe ndihmesën e dhënë nga specialistët e përfshirë në projekt, nëpërmjet një projekti (vizatimi) të zbatueshëm;
- Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim psh. zbatimin i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri në 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës;
- Për ndërtesa: paraqitje e hollësishme e dhomave dhe apartamenteve në shkallë 1:25 deri 1:1 me përshkrimin, përcaktimin e materialeve;
- Përgatitja e bazës për specialistët e tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e tyre në fazën e zbatimit;
- Azhurnimi i vazhdueshëm i projektit zbatues gjatë fazës së zbatimit.

7.6 Faza VI shërbimit: Preventivi përfundimtar

- Përcaktimi dhe mbledhja e masave për të prodhuar specifikimet e projektit duke përdorur kontributet e dhënë nga specialistët e tjerë të përfshirë në projekt;
- Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës;
- Harmonizimi dhe koordinimi i kategorive të punës së projektit të bëra nga

specialistët e përfshirë në planifikimin e projektit.

7.7 Faza VII shërbimit: Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit

- Mbledhja e të gjithë dokumenteve të preventivit dhe të kontratës së ardhshme të realizimit të objektit për të gjitha fushat e shërbimit;
- Marrja e ofertave;
- Kontrolli dhe vlerësimi i ofertave, duke bërë renditjen e masave, duke përfshirë edhe një listë me çmime për zëra të punimeve, duke siguruar përfshirjen e të gjithë specialistëve, që kanë marrë pjesë në fazat e shërbimit VI edhe VII;
- Koordinimi dhe mbledhja e shërbimeve të specialisteve, që marrin pjesë në procesin e vlerësimit;
- Negocimi me ofertuesit në tender;
- Parashikimi i shpenzimeve i bazuar në çmimin e ofruar për njësi ose në total;
- Marrja pjesë (ndihma) në kontrollin e shpenzimeve duke krahasuar shpenzimet e parashikuara me llogaritjen e shpenzimeve;
- Merrja pjesë në vendosjen e fituesve të tenderit dhe në bërjen e kontratave.

7.8 Faza VIII e shërbimit: Mbikëqyrja e punimeve

- Vëzhgimi i realizimit të objektit në përputhshmëri me lejet dhe miratimet e ndërtimit, zbatimin e vizatimeve dhe veçantitë e projektit dhe me standartet teknike të gjithësisht të pranuar dhe me rregullat në fuqi;
- Mbikëqyrje e fazës së realizimit të strukturave mbajtëse të përcaktuara në nenin 40, pika 2, nën-pika i) dhe ii) për përputhshmëri me provën e qëndrueshmërisë;
- Koordinimi i aktivitetit të specialistëve të përfshirë në mbikëqyrjen e projektit;
- Vëzhgimi dhe korrigjimi i detajeve të përbërësve të parapërgatitur (parafabrikeve);
- Përgaditja dhe ndjekja e një plani dinamik / program pune (grafike me kollona);
- Mbajtja e ditarit të kantierit;
- Kryerja e matjeve në kantier në bashkpunim me kontraktorin ndërtues;
- Miratimi dhe pranimi i fazave të punimeve të ndërtimit me përfshirjen e specialistëve të tjerë pjesëmarrës si në planifikim edhe në mbikëqyrje, identifikimi i defekteve;
- Kontrolli i faturave dhe i kontabilitetit;
- Kontrolli dhe përlllogaritja e kostos përfundimtare reale.
- Bërja e kërkesës për aprovimin (lejet e ndryshme ligjrisht të përcaktuara) nga ana e enteve publike dhe pjesëmarrje në koalidime.

- Dorëzimi i objektit duke përfshirë dorëzimin dhe përmbledhjen e të gjithë dokumenteve të nevojshme psh. udhëzimet e përdorimit të paisjeve, raportet e provave; etj.
- Listimi i periudhave të garancive për riparime të detyrueshme nga kontraktorët;
- Kontrolli i veprimeve korrigjuesenë rast konstatimit të difekteve të zbuluara gjatë periudhës së garancisëkontraktuale dhe në asnjë rast jo më shumë se tre vjet pas dorëzimit të objektit;
- Kontrolli dhe raporti i kostos përfundimtare të objektit duke krahasuar faturat e ndërtuesve me çmimet e kontratave dhe me parashikimin e shpenzimeve. (preventivin).

7.9 Faza IX e shërbimit: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar, mbikëqyrjaestetike dhe kolaudimi.

- Kontroll në objekt verifikimi i të metave eventuale të konstatuara brënda afatit të garancisë dhe jo më vonë se tre vite pas marrjes në dorëzim të punimeve;
- Mbikëqyrje të veprimeve korrigjuese të difekteve që u dalluan para skadimit të afateve të garancive kontraktuale ose të paktën në tre vitet e para pas pranimit të punimeve të ndërtimit;
- Ndihma me detyrimet e sigurisë dhe të garancive;
- Mbledhje e vazhdueshme e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatet përfundimtare të projektit.

Shtojca 8.

Ref. Neni 32, paragrafi 1 dhe Neni 36, paragrafi 2: Fazat e projektimit të veprave inxhinierike dhe strukturat e transportit sipas tipologjisë së shërbimit

8.1 Faza I e shërbimit: Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit;
- Identifikimi i kushteve të përshkruara kufizuese dhe rrethanore të projektit;
- Për objektet sipas nenit 30 pika vi) dhe vii), të cilat kërkojnë planifikimin e ngarkesës që mbajnë strukturat: Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit në aspektin e strukturave mbajtëse (statik/ dinamik);
- Inspektimet në terren;
- Mbledhja e të gjitha propozimeve të planifikimit që kanë një ndikim në projekt;
- Hartimi dhe vlerësimi i dokumentacionit;
- Vlerësimi dhe shpjegimi i të gjithë të dhënave të projektit;
- Përcaktimi i qëllimit dhe nevojës paraprake të punës p.sh. Vlerësimet e nëntokës, mbikëqyrja, mbrojtja nga emetimet;
- Formulimi i kriterëve për zgjedhjen e specialistë të tjerë për të ndihmuar me punën e planifikimit;
- Përmbledhja e rezultateve.

8.2 Faza II e shërbimit: Projekt idea paraprake(përgatitja e projektit dhe ecurisë projektuese)

- Analiza e të dhënave bazë dhe e parimeve;
- Harmonizimi i objektivave me kushte kufizuese që rezultojnë në mënyrë specifike nga politikat rajonale, planifikimi shtetëror, planet e përdorimit të tokës urbane, planet kornizë lokale dhe rajonale;
- Hartimi i zgjidhjeve të mundshme alternative dhe efektet e tyre në ndërtimin dhe projektimin e faktorëve, efektiviteti i kostos duke mos harruar pajtueshmerinë me mjedisin;
- Gjetja dhe analizimi i hartave zyrtare;
- Hartimi i një strategjie të projektimit duke përfshirë shqyrtimin e zgjidhjeve të mundshme alternative me të njëjtat kushte dhe paraqitja e projekteve dhe vlerësimeve, duke përfshirë kontributet e specialistëve të tjerë në ekipin e

projektit;

Në strukturat e transportit: Matja e përafërt për qëllime inxhinierike të trafikut; matja e emetimeve të zhurmës nga pikat kritike të objektit të transportit duke përdorur të dhënat tabelare; hetimi i masave të mundshme për mbrojtjen nga zhurma përjashtuar studimet e detajuara inxhinierike të zhurmës e sidomos në situata komplekse;

- Qartësimi dhe shpjegimi i faktorëve kyç të specializuar, proceset dhe kushtet;
- Negociatat paraprake me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me kushtet e miratimit dhe ku egzistojnë subvencionet që mund të përftohen nga projekti si dhe financimet e përbashkëta;
- Bashkveprim në shpjegimin e strategjisë së projektimit për komitetet publike dhe politike nëse është e nevojshme;
- Rishikimi i strategjive të projektit për të marrë parasysh kritikën dhe sugjerimet;
- Përgatitja e dokumentacionit në formën e ekstrakteve nga projektet paraprak për përdorim në procedurat e politikave të përdorimit të tokës që përfshihen në planin e përgjithshëm vendor;
- Llogaritja e kostos paraprake;
- Mbledhja e rezultateve nga të gjitha aktivitetet paraprake të projektimit.

8.3 Faza III e shërbimit: Projekt idea përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

- Përpunimi i mëtejshëm i strategjisë së projektimit (hap pas hapi, i alternativave të ndërtimit në formë vizatimi) duke marrë parasysh të gjitha kërkesat dhe duke përdorur kontributet e specialistëve të tjerë të përfshirë në këtë projekt, përmes përfundimit të projektit final;
- Raporti shpjegues;
- Llogaritjet e specializuara, përjashtuar llogaritjet e strukturave mbajtëse;
- Paraqitja e hartimit të përgjithshëm të projektit të plotë në formë vizatimore;
- Plani i financimit; grafiku i punimeve/plani dinamik dhe plani i kostove, preventive, përgaditja e kërkesave për financimin; identifikimi dhe justifikimi i shpenzimeve të pranueshme dhe përgatitja e aplikimeve për financim. Shpjegimin e projektimit paraprak në komitetet publike dhe politike (këshillin vendor ose qëndror nëse është e nevojshme). Rishikimi i projektit paraprak duke marrë parasysh kritikën dhe sugjerimet;
- Negociatat me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në këtë projekt lidhur me pajtueshmërinë dhe me kushtet e miratimit;
- Llogaritja e kostos;
- Kontrolli i kostos duke krahasuar vlerat e kostos paraprake me preventivat;

- Në rastin e strukturave të transportit: Specifikimi i përafërt i dimensionimin të punimeve të veprave inxhinierike; mbledhja e të gjithë dokumentacionin paraprak të projektimit; zhvillimi i projektimit paraprak me një dizajn të formës së prerë; përcaktimi i emetimeve të zhurmës nga strukturat e transportit; përcaktimi i masave të nevojshme për mbrojtjen nga zhurma në vetë instalimet e strukturave të transportit ku është e aplikueshme, përfshirë rezultatet e detajuara, studimet inxhinierike të zhurmave, që krijojnë nevojën për masa për mbrojtjen nga zhurmat në ndërtesat e prekura. Llogaritje e specifikimeve të objektit në drejtim të pikave/nyjeve kryesore dhe pikat jo kryesore; prezantimi i efekteve mbi kërkesat e detyrueshme; dokumentimi i profilit të lejes së kalimit; vlerësim i përafërt për fazat kryesore të ndërtimit duke pasur parasysh devijimin e trafikut gjatë ndërtimit;
- Përmbledhja e rezultateve nga i gjithë dokumentacioni i projektimit.

8.4 Faza IV e shërbimit: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Përgatitja e dokumentacionit të aplikimit për procedurat e miratimit të kërkuara sipas Rregulloreve të planifikimit në fuqi duke përfshirë kërkesat për përjashtimet dhe heqja dorë, hartimi i grafikut kohor të punimeve duke përdorur kontributet e bëra nga specialistë të tjerë të përfshirë në projekt;
- Dorëzimi i dokumentacionit tek entet përgjegjëse;
- Plani i blerjes së sheshit të ndërtimit dhe grafiku i planifikimit; plani i organizimit të punimeve;
- Strukturat e transportit: përpunimi i rezultateve të studimeve inxhinierike të detajuara për zhurmat;
- Negociatat me autoritetet vendore;
- Plotësimi dhe ndryshimi si një nevojë e kërkesave të planifikimit, përshkrimi dhe kostot e dhëna nga kontributi i specialistëve të tjerë të përfshirë në projekt;
- Ndhima dhe shpjegimi i strategjisë së projektimit në publik;
- Ndhima në procedurat e detyrueshme të konsultimit përfshirë edhe praninë në takimet konsultative dhe ndihma në hartimin e përgjigjeve për kritikën dhe sugjerimet.

8.5 Faza V e shërbimit: Projekti i zbatimit

- Rishikim i rezultateve të fazës III dhe IV të shërbimit (hap pas hapi, zhvillimin dhe prezantimin e zgjidhjeve të projektimit) duke marrë parasysh të gjitha kërkesat e specializuara dhe duke përdorur kontribute nga specialistë të tjerë të përfshirë në këtë projekt, nëpërmjet një projekti të zbatueshëm;
- Përpunimi dhe hartimi i projektit të përgjithshëm në formën e vizatimit dhe llogaritjeve duke përfshirë të gjithë dhënat e kërkuara për zbatim duke përfshirë detaje vizatimet në shkallët e kërkuara;

- Zhvillimi i parimeve të projektimit për specialistë të tjerë të përfshirë në projekt dhe përfshirja e kontributeve të tyre përmes një zgjidhje të realizueshme;
- Përditësimi i vazhdueshëm e zbatimit të vizatimeve gjatë fazës së zbatimit;\

8.6 Faza VI e shërbimit: Preventivi përfundimtar

- Llogaritja e sasive dhe detajeve duke përdorur kontributet nga specialistë të tjerë të përfshirë në planifikimin e projekteve;
- Hartimi i dokumentacionit të tenderit, veçanërisht në përgatitjen e specifikimeve të projektit me grafikun kohor të detajuar të punimeve dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Harmonizimi dhe koordinimi i dokumentacionit të tenderit të hartuar nga specialistët e tjerë të përfshirë në planifikimin e projektit;
- Specifikimi i fazave kyçe të tipologjisë së shërbimit.

8.7 Faza VII e shërbimit: Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit

- Sistemimi i dokumentacionin për formulimin e kontratës për të gjitha zonat e shërbimit;
- Mbledhja e ofertave;
- Kontrollimi dhe vlerësimi i ofertave duke bërë renditjen e vlerave dhe përgatitja të listës së çmimeve;
- Bashkërendimi dhe mbledhja e shërbimeve të specialistëve që ndihmuan nënxjerrjen e çmimeve;
- Asistimi në negociatat me ofertuesit;
- Përditësimi i llogaritjeve të kostos;
- Kontrollimi i kostos duke krahasuar vlerat e llogaritura me vlerësimet e preventivave (nga krahasimi i kostos së llogaritur dhe asaj të ndërtimit);
- Përditësimi me llogaritjen e kostos;
- Asistimi gjatë firmosjes së kontratës.

8.8 Faza VIII e shërbimit: Mbikëqyrja e punimeve

- Mbikëqyrja dhe menaxhimi në terren i projektit, kur menaxhimi i ndërtimit dhe mbikëqyrja e ekzekutimit në vend janë me kontrata të ndryshme, koordinimi i punëve me specialistë të fushave të përfshirë në mbikëqyrjen e projektit, veçanërisht duke përfshirë kontrollin e konformitetin të projektit të miratuar, prodhuar nga palë të treta;
- Përgaditja dhe mbikëqyrja e grafikut të punimeve/planit dinamik (në formë

diagrami, GANT, etj.)

- Marrja e masave për realizimit të grafikut të punimeve nëpërmjet kontrollit dhe/ose penalizimit të kontraktorëve;
- Miratimi dhe pranimi i punimeve nëpërmjet përfshirjes së menaxhimit të kantierit nga specialistë të tjerë të përfshirë në të dy fazat, planifikimin dhe mbikëqyrjen e projektit, mbështetja dhe firmosja e rezultatit të provave të kolaudit;
- Aplikimet për inspektimet/koalidimet zyrtare dhe pjesëmarrja në to;
- Dorëzimi i projektit duke përfshirë krahasimin dhe dhënien e dokumentacionit të nevojshëm, psh nënshkrimet e pranimi, raportet e provave të kolaudit;
- Hartimi i udhëzime të mirëmbajtjes për objektin;
- Monitorimi dhe testimi i kapacitetit funksional të komponentëve të sistemit dhe të gjithë sistemin;
- Listimi i afateve kohore të kërkuara për garancinë;
- Llogaritja e kostos faktike;
- Kontrolli i kostos duke krahasuar faturat e kontraktorit që ndërton kundrejt çmimeve të kontratës dhe llogaritjen e kostos së përditësuar.

8.9 Faza IX e shërbimit: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar, mbikëqyrja estetike dhe kolaudimi.

- Kontroll në objekt verifikimi i të metave eventuale të konstatuara brënda afatit të garancisë dhe jo më vonë se tre vite pas marrjes në dorëzim të punimeve;
- Mbikëqyrje të veprimeve korrigjuese të difekteve që u dalluan para skadimit të afateve të garancive kontraktuale ose të paktën në tre vitet e para pas pranimi të punimeve të ndërtimit;
- Ndihma me detyrimet e sigurisë dhe të garancive;
- Mbledhje e vazhdueshme e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatet përfundimtare të projektit.

Shtojca 9.

Ref. Neni 39, paragrafi 1:

Planifikimi i strukturave mbajtëse sipas tipologjisë së shërbimit

9.1 Faza I e shërbimit: Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit për fushat specifike të strukturave mbajtëse. E rëndësishme në këtë fazë është konsultimi me inxhinierët dhe arkitektët e projektit.

9.2 Faza II e shërbimit: Projekt idea paraprake (përgatitja e bazave të projektit dhe përgaditja për projektim)

- Për projekte të veprave inxhinierike, siç përcaktohet në nenin 30, pika vi) dhe vii): ndërthurja e rezultateve sipas fazës I së shërbimit, në Shtojcën 7;
- Këshillim për çështje të projektimit të strukturës mbajtëse, duke marrë parasysh kërkesat mbi stabilitetin, funksionin dhe koston;
- Ndihmë zhvillimin e një strategjie të projektimit, duke përfshirë shqyrtimin për strukturat mbajtëse nën të njëjtat kërkesa të projektit dhe të hartimit një tabele të detajuar duke deklaruar specifikimet kryesore të projektit për strukturat mbajtëse, p.sh. materialet e ndërtimit, preceset e ndërtimit dhe të prodhimit, skemat e ndërtimit dhe llojet e themeleve;
- Negociatat paraprake me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me pajtueshmërinë dhe kushtet e miratimit;
- Ndihma në llogaritjen e koston paraprake edhe në rastin e ndërtesave dhe objekteve strukturore.

9.3 Faza III e shërbimit: Projekt idea përfundimtare (sistemet dhe integrimi i tyre në projekt)

- Zhvillimi i strukturës mbajtëse duke marrë parasysh planet e propozuara nga specialistët, si pjesë përbërëse për hartimin e projektit idesë përfundimtare, përfshirë këtu edhe paraqitjen grafike;
- Bërja e llogaritjeve të përafërta statike dhe dimensionimi i përafërt i kolonave;
- Specifikimi i detajeve themelore të projektimit dhe dimensionet kryesore të ngarkesës së strukturave për të lejuar, p.sh. projektimin e pjesëve të rëndësishme, pjesët e futura të ndërtesës, nyjet dhe bashkimet, si dhe pikat mbajtëse të përbashkëta;

- Ndihma me specifikimet e projektit;
- Ndihma në negociata me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me kushtet e miratimit;
- Ndihma me llogaritjen e kostos edhe në rastin e ndërtesave dhe impjanteve strukturore;
- Ndihma gjatë kontrollit të kostos duke krahasuar koston paraprake me koston e llogaritur.

9.4 Faza IV e shërbimit: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Përgatitja e llogaritjeve statistiko-dinamike të auditueshme për strukturat mbajtëse duke marrë parasysh kërkesat e përshkruara në ligjet dhe normat në fuqi;
- Veprat inxhinierike: Përshkrimi i kushteve normale të realizimit;
- Përgatitja e vizatimeve, planeve të pozicionit për strukturat mbajtëse me përlllogaritjet statike, dimensionet e strukturave mbajtëse, ngarkesat e peshës së shtuar, llojin dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe karakteristikat të veçanta të strukturave në projekt në vizatimin projektit arkitektonik (psh. në fletë transparente ose në një layer të mbivendosur);
- Sistemimi i dokumentacionit për projektin e strukturave mbajtëse për të marrë aprovimin e projektit dhe pëlqimet e parashikuara me ligj;
- Negocimi me qëndrat e testimit dhe inxhinierë që merren me testimin e objektit;
- Kompletimi dhe ndryshimi i llogaritjeve dhe vizatimeve.

9.5 Faza V e shërbimit: Projekti i zbatimit

- Rishikimi / ripërpunimi i rezultateve të Fazës III-të dhe IV-ërt, të shërbimit duke marrë parasysh planet e specializuara të integruara në planin e projektit;
- Përgatitja e vizatimeve të betoniformave/kallepëve si dhe të shtesave të projektit arkitekturor;
- Paraqitja e strukturave mbajtëse në formë të vizatuar duke përfshirë instalimet dhe udhëzimet e shtrirjes së hekurit, psh. vizatimet e përforcimeve, punimit të hekurit, kornizat e drurit;
- Hartimi i listave të detajuara ose me njësi e hekurit për të plotësuar vizatimet e projektimit, gjithashtu paraqitja e llogaritjeve të sasisë së tij.

9.6 Faza VI e shërbimit: Preventivi përfundimtar

- Përcaktimi i sasisë së hekurit të armimit të nevojshëm për beton armën B/A, sasinë e hekurit, dhe sasinë e drurit për teknikat e kornizave si një kontribut për llogaritjet e sasisë nga ana e arkitektit projektues;
- Kryerja e llogaritjeve të përafërta për komponentët strukturorë të hekurit dhe lidhjet statikisht të nevojshme për ndërtimet me strukturë druri;
- Përcaktimet dhe specifikimet e projektit për të plotësuar llogaritjet sasiore si një bazë për preventivin për strukturën mbajtëse.

Shtojca 10.

Ref. Nenit 43, paragrafi 1: Sistemet teknike sipas tipologjisë

10.1 Faza I e shërbimit: Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit

- Përcaktimi i kërkesave bazë të shërbimeve teknike në konsultim me klientët dhe arkitektin e projektit, sidomos në lidhje me çështjet teknike dhe financiare;
- Përmbledhja e rezultateve.

10.2 Faza II e shërbimit: Projekt idea paraprake (përgatitja për projektim dhe për planifikim)

- Analizimi i principeve kryesore;
- Zhvillimi dhe dizenjimi i një draft strategjie sipërfaqësore të sistemeve teknike kryesore dhe komponentëve të tyre duke përfshirë dhe ekzaminimin e zgjidhjeve të mundshme alternative të projektit, të bazuara në të njëjtat kushte dhe të prezantuara në vizatime, që tregojnë integrimin e tyre në plan-projektet, përfshirë dhe treguesit paraprak të eficiencës ekonomike;
- Përgatitja e një matrice funksionale ose të një diagrame, për secilin instalim;
- Shpjegimi dhe qartësimi i specialiteteve dhe faktorëve kyç të proceseve dhe kushteve;
- Asistimi me negociatat paraprake me autoritet lokale dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt në respekt të zbatimit të kushteve për aprovim;
- Asistimi në llogaritjen e kostos paraprake edhe për instalimin në ndërtesë;
- Përmbledhja e dokumentacionit të përgaditur në projektimin paraprak.

10.3 Faza III e shërbimit: Projektidea përfundimtare (sistemet dhe integrimi i tyre në projekt)

- Rishikimi dhe përpunimi i strategjisë së projektimit (sqarimi hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh të gjitha kërkesat dhe veprimi në përputhje me të gjitha planet e specialistëve të integruar në planin e projektit, deri në projekt idenë përfundimtare;
- Specifikimi i të gjitha sistemeve teknike dhe komponenteve të tyre;
- Kryerja e llogaritjeve dhe dimensionimi, plus pamjet e vizatuara dhe planimetritë e përshkruara;

- Përcaktimi dhe koordinimi me konstruktorin i të gjithë hapjeve, perforceve të strukturës mbajtëse dhe i peshave suplementare të vazhdueshme dhe dinamike të sistemeve (pa paraqitjen e planeve të perforceve);
- Bashkëpunimi në negociatat me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në përputhje me kushtet miratimit;
- Bashkëpunimi për llogaritjen e kostos edhe në rastin e instalimeve në ndërtesa;
- Bashkëpunimi në kontrollin e kostos duke krahasuar koston paraprake me koston e llogaritur.

10.4 Faza IV e shërbimit: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për marrjen e miratimeve zyrtare dhe aprovimet e nevojshme në bazë legjislativore në fuqi, duke përfshirë aplikimet për rastet jo të zakonshme dhe përjashtimet, plus çdo negociatë e mbetur me autoritetet publike;
- Sistemimi i dokumentacionit;
- Plotësimi dhe korrigjimi sipas nevojës i dokumentacionit të projektit, përshkrimeve dhe llogaritjeve.

10.5 Faza V e shërbimit: Projekti i zbatimit

- Rishikimi dhe përpunimi i detajuar i rezultateve të fazave III dhe IV të shërbimit (zhvillimi hap pas hapi i zgjidhjes dhe paraqitja në formë të vizatuar) duke marrë parasysh të gjitha kërkesat dhe shërbimet e specialistit të integruara në planin e projektit, nëpërmjet një planifikimi të zbatueshëm;
- Prezantimi i vizatimeve të instalimeve duke përfshirë dimensionimin;
- Përgatitja e vizatimeve të perforceve dhe të hapjes së strukturave për kalimin e sistemeve;
- Përditësimi dhe plotësimi i vazhdueshëm dhe i detyruar i vizatimeve.

10.6 Faza VI e shërbimit: Preventivi përfundimtar

- Llogaritja e sasive për përgatitjen e preventivit, në koordinim me specialistët e tjerë të grupit të projektit;
- Përgatitja e preventivit në përputhje me planin e punës dhe në bazë të zonave të shërbimit dhe përshkrimi i detyruar i tij.

10.7 Faza VII e shërbimit: Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit

- Kontrolli i vlerësimit të ofertave duke përfshirë dhe përgatitjen e një liste çmimesh në varësi të punëve të caktuara;
- Asistimi në negociimet me ofruesit dhe përgatitja e rekomandimeve për investitorin;
- Asistimi në vlerësimin e ofertave për njësi ose aforfe edhe për instalime në ndërtesa;
- Asistimi me kontrollin e kostove duke krahasuar koston paraprake me koston e përlogaritur (preventivin);
- Asistimi në nënshkrimin e kontratës.

10.8 Faza VIII e shërbimit: Mbikëqyrja e punimeve

- Kontrolli i zbatimit të projektit, në përputhje me lejen e ndërtimit, zbatimit të vizatimeve, specifikimin e projektit ose planeve të punës në bazë të parimeve teknike të përgjithshme të pranuar dhe rregullave të aplikuara;
- Asistimi për përgatitjen dhe monitorimin e planit të veprimit, grafiku i punimeve, planit dinamik;
- Asistimi në mbajtjen e ditarit të kantierit;
- Bashkëveprimi në kryhen matjeve nga kontraktorët e ndërtimit;
- Marrja në dorëzim e shërbimeve të specializuara dhe identifikimin e gabimeve;
- Kontrolli i kontabilitetit;
- Asistimi në llogaritjen e koston faktike edhe për instalime në ndërtesa;
- Aplikimi për inspektimet zyrtare të rregulluara me ligj dhe pjesëmarrja në to;
- Sistemi dhe dorëzimi i dokumenteve kolaudit, udhëzimeve të përdorimit dhe raportet e testimit;
- Ndihma me listimin e periudhave të garancisë;
- Monitorimi dhe veprimet korrigjuese lidhur me defektet e identifikuara gjatë inspektimeve të marrjes në dorëzim;
- Ndihma dhe asistimi me kontrollin e koston duke krahasuar faturat e kontraktorëve të ndërtimit me çmimet e kontratave dhe koston e llogaritur.

10.9 Faza IX e shërbimit: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe perkujdesja për objektin

- Kontroll në objekt, verifikimi i të metave eventuale të konstatuara brenda afatit të garancisë dhe jo më vonë se tre vite pas marrjes në dorëzim të punimeve;
- Mbikëqyrje të veprimeve korrigjuese të difekteve që u dalluan para skadimit të afateve të garancive kontraktuale ose të paktën në tre vitet e para pas pranimit të punimeve të ndërtimit;
- Ndihma me detyrimet e sigurisë dhe të garancive;
- Mbledhja e vazhdueshme e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatet përfundimtare të projektit.

Shtojca 11.

Ref. Nenit 13: Interpolimi

Në rast se kostoja e llogaritëshme (X = vlera e preventivit), është një vlerë e cila nuk gjendet në tabelë atëherë do të përdorimin formulën e interpolimit për të gjetur tarifën, e cila do të llogaritet si më poshtë:

Në fillim do të gjejmë në tabelë kostot e llogaritëshme, mes të cilave ndodhet kostoja e llogaritëshme (X) për të cilën duam të llogarisim tarifat.

Kostoja e llogaritëshme $K1$ me vlerë minimale (a) vlerë maksimale (b)

Kostoja e llogaritëshme $K2$ me vlerë minimale (c) vlerë maksimale (d)

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave a dhe b sipas formulës:

$$H1 = a + (0 \div 1) \times (b - a)$$

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave c dhe d sipas formulës:

$$H2 = c + (0 \div 1) \times (d - c)$$

Llogarisim diferencën e kostove të llogaritëshme reale $X - K1 = D1$

Llogarisim diferencën mes dy kostove $K2 - K1 = D2$

Llogarisim diferencën minimale/maksimale:

$$H2 - H1 = D3 \text{ min}$$

$$H2 - H1 = D3 \text{ max}$$

Formula e interpolimit për tarifën minimale, do të jetë:

$$H1 + \frac{D3 \text{ min} \times D1}{D2}$$

$$a + 0 \times (b - a) + \frac{[(c + 0 \times (d - c)) - (a + 0 \times (b - a))] \times (X - K1)}{K2 - K1} = \text{tarifa minimale}$$

Formula e interpolimit për tarifën maksimale do të jetë :

$$H1 + \frac{D3_{\max} \times D1}{D2}$$

$$a + 1 \times (b-a) + \frac{[(c+1 \times (d-c)) - (a+1 \times (b-a))] \times (X-K1)}{K2 - K1} = \text{tarifa maksimale}$$

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakord mes palëve, gjatë momentit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jetë mes kufijve minimalë dhe maksimalë të mësipërm.

Shtojca 12.

Shembuj Aplikimi

Shembull 1

Më poshtë po paraqesim një rast konkret se si duhet të llogarisim tarifat e projektimit të një shkolle 9 vjecare.

1. Llogaritja e tarifave të projektimit për arkitektin

Hapi i parë: Nxjerja e vlerës së kostos së llogaritshme.
Hartojmë preventivin paraprak.

Vlera e preventivit doli **16,259,635 lekë** pa tvsh, nga ku :

- Punimet e strukturave mbajtëse (B/ A dhe mure mbajtëse) shkojnë
1,386,775 lekë
- Punimet e sistemeve teknike :

2.1 Sistemet Elektrike:	489,803 lekë
2.2 Sistemet Hidrosanitare:	317,647 lekë
2.3 Sistemi Termoteknik	344,857 lekë
	1,152,307 lekë

Hapi i dytë: Kontrolli i kostove të llogariteshme i sistemeve teknike në raport me koston e ndërtimit, referuar nenit 22, pika 2

Kosto e llogaritëshme e sistemeve teknike	1,152,307		=	$\frac{1,152,307}{16,259,635}$	= 7%
Kosto totale e ndërtimit				16,259,635	

-Në këtë rast përderisa kostoja e llogaritshme e sistemeve teknike nuk e kalon vlerën 15% të koston totale të projektit, atëhere si kosto e llogaritëshme do të meret vlera e preventivit.

-Në rast se kostoja e llogaritshme e sistemeve teknike do ta kalonte vlerën 15% të koston totale të projektit, atëhere si kosto e llogaritëshme do të merrej:

- Vlerës së preventivit do t'i zbritet 50% e kostove të llogaritshme të sistemeve teknike .

Hapi i tretë: Përcaktimi i grupit tarifor

Për të gjetur grupin tarifor i referohemi shtojcës 3, paragrafit 3.1, në të cilën shkolla 9 vjeçare i përket grupit të IV tarifor.

Hapi i katërt: Llogaritja e tarifave të projektimit për arkitektin

Për llogaritjen e tarifës së projektimit për arkitektin, i referohemi Tabelës Nr. 5 Ndërtesat dhe Ndarjet funksionale të tyre (Neni 24).

Kostoja e llogaritëshme është 16,259,635 lekë

Objekti “ Shkollë 9 vjeçare “ i përket Grupit IV tarifor

Mesa vërehet nga tabela vlera 16,259,635 lekë = X gjendet mes dy vlerave:

K1 = 14,000,000 lekë,

ku për Grupin IV Tarifor tarifatat shkojnë nga 8.31 % (1163400 = a) +9.49% (1328600 = b)

K2 = 21.000.000 lekë,

ku për Grupin IV Tarifor tarifatat shkojnë nga 8.04% (1688400 = c) +9.13% (1917300 = d)

Në këtë rast llogaritjet do të kryhen me interpolim duke u bazuar në nenin 13, dhe shtojcën 11:

$$H1_{min} = a + 0 \times (b-a) = 1163,400 + 0 \times (1,328,600 - 1,163,400) = 1,163,400$$

$$H2_{min} = c + 0 \times (d-c) = 1,688,400 + 0 \times (1,917,300 - 1,688,400) = 1,688,400$$

$$D1 = X - K1 = 16,259,635 - 14,000,000 = 2,259,635$$

$$D2 = K2 - K1 = 21,000,000 - 14,000,000 = 7,000,000$$

$$D3_{min} = H2 - H1 = 1,688,400 - 1,163,400 = 525,000$$

$$H1_{min} + \frac{D3_{min} \times D1}{D2} = 1,163,400 \rightarrow \frac{525,000 \times 2,259,635}{7,000,000} = 1,332,873 (8.19\%)$$

$$H1_{max} = a + 1 \times (b-a) = 1163,400 + 1 \times (1,328,600 - 1,163,400) = 1,328,600$$

$$H2_{max} = c + 1 \times (d-c) = 1,688,400 + 1 \times (1,917,300 - 1,688,400) = 1,917,300$$

$$D1 = X - K1 = 16,259,635 - 14,000,000 = 2,259,635$$

$$D2 = K2 - K1 = 21,000,000 - 14,000,000 = 7,000,000$$

$$D3_{max} = H2 - H1 = 1,917,300 - 1,328,600 = 588,700$$

$$H1_{max} + \frac{D3_{max} \times D1}{D2} = 1,163,400 \rightarrow \frac{588,700 \times 2,259,635}{7,000,000} = 1,518,635 (9.3\%)$$

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakord mes palëve, gjatë momentit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jetë mes kufijve minimalë (8.19%) dhe maksimalë (9.3%), supozojmë se u ra dakord për tarifën 8.6% që i korresponon vlera: 1,398,328 lekë.

Hapi i pestë: Llogaritja e tarifave për çdo fazë projektimi

Vlera e mësipërme 1,398,328, përfshin të 9 fazat e projektimit sipas nenit 23 përkatësisht:

Nr.	Fazat e Projektimit	Përshkrimi	Tarifa për secilën fazë
1	Faza I	Analiza e detyrës së projektimit/përcaktimi i bazës së projektit	$3\% \times 1,398,328 = 41949.84$ lekë
2	Faza II	Projekt ideja paraprake	$7\% \times 1,398,328 = 97882.96$ lekë
3	Faza III	Projekt ideja përfundimtare	$11\% \times 1,398,328 = 153816.1$ lekë
4	Faza IV	Projekt për miratimin e lejes së ndërtimit	$6\% \times 1,398,328 = 153816.1$ lekë
5	Faza V	Projekt zbatimi	$25\% \times 1,398,328 = 349582$ lekë
6	Faza VI	Preventivi përfundimtar	$10\% \times 1,398,328 = 139832.8$ lekë
7	Faza VII	Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit	$4\% \times 1,398,328 = 55933.12$ lekë
8	Faza VIII	Mbikqyrja	$31\% \times 1,398,328 = 433481.7$ lekë
9	Faza IX	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudimi	$3\% \times 1,398,328 = 41949.84$ lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për arkitektin do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura.

2. Llogaritja e tarifave të projektimit për inxhinierin e ndërtimit/konstruktorit

Hapi i parë: Nxjerja e vlerës së kostos së llogaritshme.

Gjatë hartimit të preventivin paraprak punimet e strukturave mbajtëse (B/A dhe mure mbajtëse) shkojnë **1,386,775 lekë**

Hapi i dytë: Përcaktimi i grupit tarivor

Për të gjetur grupin tarivor i referohemi Nenit 40, paragrafit 2, në të cilën shkolla 9 vjeçare i përket grupit të IV tarivor.

Hapi i tretë: Llogaritja e tarifave të projektimit për inxhinierin e ndërtimit/konstruktorit

Duke iu referuar Tabelës Nr.12 *Strukturat mbajtëse* (Neni 40) konstatojmë që vlera e mësipërme është nën vlerën minimale. Në raste të tilla palët do të bien dakort për tarifën që i përket kontruksionit, por duke patur parasysh që të mos ulet përqindja nën përqindjen e parashikuar në tabelë për grupin tarifor IV (11.87%- 14.25%). Vlera absolute (në lekë) për rastin konkret duhet të jetë më poshtë se vlera absolute të përcatuara për vlerën (1,431,640 lekë), të grupit tarifor IV.

Supozojmë se u ra dakort për vlerën 950,000 lekë.

Hapi i katërt: Llogaritja e tarifave për cdo fazë projektimi

Vlera e mësipërme 950,000 përfshin të 6 fazat e projektimit sipas nenit 39 përkatësisht:

Nr.	Fazat e Projektimit	Përshkrimi	Tarifa për secilën fazë
1	Faza I	Analiza e detyrës së projektimit/përcaktimi i bazës së projektit	3% x 950,000 = 28,500 lekë
2	Faza II	Projekt ideja paraprake	10% x 950,000 = 95,000 lekë
3	Faza III	Projekt ideja përfundimtare	12% x 950,000 = 114,000 lekë
4	Faza IV	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	30% x 950,000 = 285,000 lekë
5	Faza V	Projekt zbatimi	42% x 950,000 = 399,000 lekë
6	Faza VI	Preventivi përfundimtar	3 % x 950,000 = 28,500 lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për inxhinierin konstruktor do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura

3. Llogaritja e tarifave të proktimit për inxhinierin elektrik

Hapi i parë: Nxjerja e vlerës së kostos së llogaritshme.

Kostoja e llogararitëshme për punimet elektrike të objektit duke ju referur preventivit paraprak është 489,803 lekë.

Hapi i dytë: Përcaktimi i grupit tarifor

Për të gjetur grupin tarifor i referohemi shtojcës 3, paragrafit 3.6 ku instalimet elektrike sipas kërkesave për shkollën klasifikohen në grupin II tarifor.

Hapi i tretë: Llogaritja e tarifave të projektimit për inxhinierin elektrik.

Duke iu referuar Tabelës Nr.14 *Shërbimet Teknike* (Neni 44) konstatojmë që vlera e mësipërme është nën vlerën minimale (715 820 lekë).

Në raste të tilla palët do të bien dakort për tarifën që i përket inxhinierit elektrik, por duke patur parasysh që të mos ulet përqindja nën përqindjen e parashikuar në tabelë për grupin tarifar II (13.75%- 16.9%). Vlera absolute (në lekë) për rastin konkret duhet të jetë më poshtë se vlerat absolute të përcatuara për vlerën (715,820lekë), të grupit tarifar II.

Supozojmë se u ra dakort për vlerën 105,000 lekë.

Hapi i katërt: Llogaritja e tarifave për cdo fazë projektimi

Vlera e mësipërme 105,000 përfshin të 9 fazat e projektimit sipas nenit 43 përkatësisht:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e parë	Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit	$3\% \times 105,000 = 3,150$ lekë
2	Faza e dytë	Projekt idea paraprake	$11\% \times 105,000 = 11,550$ lekë
3	Faza e tretë	Projekt idea përfundimtare	$15\% \times 105,000 = 15,750$ lekë
4	Faza e katërt	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	$6\% \times 105,000 = 6,300$ lekë
5	Faza e pestë	Projekti i zbatimit	$18\% \times 105,000 = 18,900$ lekë
6	Faza e gjashtë	Preventivi përfundimtar	$6\% \times 105,000 = 6,300$ lekë
7	Faza e shtatë	Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit	$5\% \times 105,000 = 5,250$ lekë
8	Faza e tetë	Mbikëqyrja	$33\% \times 105,000 = 34,650$ lekë
9	Faza e nëntë	Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar dhe kolaudim	$3\% \times 105,000 = 3,150$ lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për inxhinierin elektrik do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura.

Në rast se inxhinieri elektrik do të kryejë mbikqyrjen deri në përfundim të instalimit të sistemit elektrik dhe kolaudimin, kjo vlerë do të zbritet vlerës për mbikqyrjen e arkitektit e llogaritur më lart, në pikën 1, (faza 8 , tek tabela e fazave të projektimit të arkitektit) .

E njëjta llogjikë ndiqet për tarifat e shërbimeve të tjera të sistemeve teknike.

Nëse e njëjta firmë i mer përsipër ti kryejë të tëra shërbimet e sistemeve teknike (Elektrik, Hidrosanitare dhe Termoteknike) atëhere do ti referohemi vlerës së plotë të sistemeve për të vazhduar më tej me llogaritjet (konkretisht vlerës 1,152,307 lekë)

4. Llogaritja e tarifave për shërbimet topografike në fazën e projektimit

Hapi i parë: Nxjerja e vlerës së kostos së llogaritshme.

Kostoja e realizimit të objektit është 16,259,635 lekë

Në këtë fazë duke u mbështetur tek shtojca 1, pika 1.3.2.4 kostoja e llogaritëshme do të jetë:

$$16,259,635 \text{ lekë} \times 25\% = 4,064,909 \text{ lekë}$$

Hapi i dytë: Përcaktimi i grupit tarifor

Për të përcaktuar grupin tarifor na ndihmon sistemi i pikëzimit, sipas shtojcës 1, pika 1.3.3.1 si më poshtë:

i) Cilësia e hartave ekzistuese, **5 pikë** sepse nuk egziston hartë për zonën ku do të ndërtohet shkolla

ii) Kërkesa në lidhje me saktësinë e cilësinë e pikave ekzistuese të pozicionit dhe lartësisë për pikat e palëvizshme, **5 pikë** sepse nuk ka pika ekzistuese të pozicionit dhe të lartësisë

iii) Të dhëna mbi pozicionin dhe lartësinë e pikavetë palëvizshme ekzistuese, **5 pikë** sepse nuk ka pika të palëvizshme ekzistuese

iv) Probleme për sa i përket natyrës së tokës dhe kalimeve të këmbësorëve, **5 pikë** sepse objekti ndodhet në zonë me terren relativisht të sheshtë dhe pranë një rruge sekondare ku nuk ka lëvizshmëri të lartë

v) Pengesat nga bimësia, **3 pikë** sepse zona nuk ka bimësi të lartë , por ka shkure qe nuk pengojnë pamjen.

vi) Pengesat nga trafiku **0 pikë** sepse sic e thame nuk ka rrugë me trafik afër

vii) Densiteti i karakteristikave topografike **10 pikë** sepse terreni ka elementë si kanale, ndryshime kuotash dhe formash të cilat duhet të përcaktohen me saktësi .

Në fund do të llogarisim totalin e pikëve: **33 pikë**

Përcaktojmë grupin tarifor në bazë të shtojcës 1, paragrafi 1.3.3.2 :

Grupi I Tarifor:	Rilevim deri në 14 pikë,
Grupi II Tarifor:	Rilevim nga 15-25 pikë,
Grupi III Tarifor:	Rilevim nga 26-37 pikë,
Grupi IV Tarifor:	Rilevim nga 38-48 pikë,
Grupi V Tarifor:	Rilevim nga 49-60 pikë,

Shërbimi lidhur me tarifën për topografinë, në fazën e projektimit i përket grupit tarifor III

Hapi i tretë: Llogaritja e tarifave për shërbime topografike, në fazën e projektimit

Për llogaritjen e tarifës së projektimit për topografinë, në fazën e projektimit i referohemi Tabelës Nr 7, *Tabela shoqëruese e tarifave për shërbimet e rilevimeve topografike* (Shtojca 1)

Kostoja e llogaritëshme është 4,064,909 lekë
Shërbimi topografik i përket Grupit tarifor III

Sic vihet re nga tabela, vlera e mësipërme gjendet mes dy vlerave :
 $K1 = 3,000,000$ lekë ku për Grupin III Tarifor tarifat shkojnë nga 2.74% ($82,079=a$) në 3.04% ($91,326=b$)
 $K2 = 5,000,000$ lekë ku për Grupin III Tarifor tarifat shkojnë nga 2.56% ($127,798=c$) në 2.86% ($143,210=d$)

Në këtë rast llogaritjet do të kryhen me interpolim duke u bazuar tek neni 13, dhe shtojcën 11

$$\begin{aligned}H1_{\min} &= a + 0 \times (b-a) = 82,079 \\H2_{\min} &= c + 0 \times (d-c) = 127,798 \\D1 &= X - K1 = 1,064,909 \\D2 &= K2 - K1 = 2,000,000 \\D3_{\min} &= H2 - H1 = 45,719\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}H1_{\min} + \frac{D3_{\min} \times D1}{D2} &= 82,079 + \frac{45,719 \times 1,064,909}{2,000,000} = 106,422 \text{ (2.62\%)} \\H1_{\max} &= a + 1 \times (b-a) = 91,326\end{aligned}$$

$$H2_{\max} = c + 1 \times (d-c) = 143,210$$

$$D1 = X - K1 = 1,064,909$$

$$D2 = K2 - K1 = 2,000,000$$

$$D3_{\max} = H2 - H1 = 51,884$$

$$H1_{\max} + \frac{D3_{\max} \times D1}{D2} = 91,326 + \frac{51,884 \times 1,064,909}{2,000,000} = 118,951 \text{ (2.93\%)}$$

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakort mes palëve , gjatë momentit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jete mës kufijve minimalë (2.62%) dhe maksimalë (2.93%), supozojmë se u ra dakort për tarifën 2.8 % që i korresponon vlera: 113,817 lekë

Hapi i katërt: Llogaritja e tarifave për cdo fazë projektimi

Vlera e mesipërme 113,817 lekë përfshin të 6 fazat e projektimit sipas shtojces 1, pikës 1.3.4.1 përkatësisht:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I -rë	Analiza e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit	3% x 113,817 = 3,414.5 lekë
2	Faza e II-të	Grupimi i pikave të palëvizshme gjeodezike	15% x 113,817 = 17,073 lekë
3	Faza e III-të	Planet e pozicionimit dhe të rilevimit	52% x 113,817 = 59,185 lekë
4	Faza e IV- ërt	Vizatime të piketave	15% x 113,817 = 17,073 lekë

5	Faza e V -të	Projekti i zbatimit: Piketat për qëllime planifikimi	$5\% \times 113,817 = 5,690.9$ lekë
6	Faza e VI -të	Seksionet gjeologjike	$10\% \times 113,817 = 11,382$ lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për topografin do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura.

5. Llogaritja e tarifave për shërbimet topografike në fazën e zbatimit

Hapi i parë: Nxjerrja e vlerës së kostos së llogaritshme.

Kostoja e realizimit të objektit është 16,259,635 lekë

Në këtë fazë duke u mbështetur tek shtojca 1, pika 1.3.5.2 kostoja e llogaritëshme do të jetë :

$16,259,635 \text{ lekë} \times 60 \% = 9,755,781 \text{ lekë}$

Hapi i dytë: Përcaktimi i grupit tarifor

Për të përcaktuar grupin tarifor na ndihmon sistemi i pikëzimit, sipas shtojcës 1, pika 1.3.6.3 si më poshtë:

i) Ndikimi i strukturavetë relievit dhe nga karakteristika për të qarkulluar mbi të; **3 pikë** sepse zona nuk ka bimësi të lartë , por ka shkure të cilat mundësojnë një hyrje në tërren jo me shumë vështirësi.

ii) Pengesa nga ndërtimi dhe bimësia; **5 pikë** sepse zona nuk ka bimësi të lartë , por ka shkure të cilat mundësojnë një hyrje në tërren jo me shumë vështirësi.

iii) Pengesa nga trafiku; **0 pikë** sepse sic e thame nuk ka rrugë me trafik afër

iv) Kërkesa për saktësinë; **10 pikë** sepse objekti duhet të pozicionohet saktë dhe të lidhet me kuotat e terrenit sipas kondicioneve urbane

v) Kërkesa në lidhje me gjeometrinë e objektit; **5 pikë** sepse projekti është ortogonal, akset janë paralel me njëri tjetrin, nuk ka ballkone dhe parapete me forma të vështira gjeometrike për piketim.

vi) Pengesa nga veprimtaritë në kantier. **10 pikë** sepse kantjeri është vetëm për një objekt dhe punohet lehtësisht brenda tij,

Ne fund do të llogarisim totalin e pikëve **33 pikë**

Përcaktojmë grupin tarifor si më poshtë:

Grupi I Tarifor:	Rilevim deri në 14 pikë,
Grupi II Tarifor:	Rilevim nga 15-25 pikë,
Grupi III Tarifor:	Rilevim nga 26-37 pikë,
Grupi IV Tarifor:	Rilevim nga 38-48 pikë,
Grupi V Tarifor:	Rilevim nga 49-60 pikë,

Shërbimi i lidhur me tarifës për topografinë, në fazën e zbatimit i perket grupit tarifor III

Hapi i tretë: Llogaritja e tarifave për shërbimet topografike, në fazën e zbatimit

Për llogaritjen e tarifës së projektimit për topografinë, në fazën e projektimit i referohemi Tabelës Nr 7, *Tabela shoqëruese e tarifave për shërbimet e rilevimeve topografike* (Shtojca 1)

Kostoja e llogaritëshme është 9,755,781 lekë = X
Shërbimi topografik i përket Grupit tarifor III

Sic vihet re nga tabela vlera e mesipërme gjendet mes dy

$K1 = 7,000,000$ lekë ku për Grupin III Tarifor tarifat shkojnë nga 2.38% ($166,600 = a$) në 2.68% ($187,600 = b$)

$K2 = 14,000,000$ lekë ku për Grupin III Tarifor tarifat shkojnë nga 1.73% ($242,200 = c$) 1.93% ($270,200 = d$)

Në këtë rast llogaritjet do të kryhen me interpolim duke u bazuar në neni 13, dhe shtojcën 11 :

$$H1_{min} = a + 0 \times (b-a) = 166,600$$

$$H2_{min} = c + 0 \times (d-c) = 242,200$$

$$D1 = X - K1 = 2,755,781$$

$$D2 = K2 - K1 = 7,000,000$$

$$D3_{min} = H2 - H1 = 75,600$$

$$H1min + \frac{D3min \times D1}{D2} = 166,600 \quad \frac{75,600 \times 275,5781}{7,000,000} = 196,362.5 (2.01\%)$$

$$\begin{aligned} H1max &= a + 1 \times (b-a) = 187,600 \\ H2max &= c + 1 \times (d-c) = 270,200 \\ D1 &= X - K1 = 2,755,781 \\ D2 &= K2 - K1 = 7,000,000 \\ D3max &= H2 - H1 = 82,600 \end{aligned}$$

$$H1max + \frac{D3max \times D1}{D2} = 187,600 \quad \frac{82,600 \times 2,755,781}{7,000,000} = 220,118.2 (2.26\%)$$

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakort mes palëve , gjatë momentit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jete mës kufijve minimalë (2.01%) dhe maksimalë (2.26%), supozojmë se u ra dakort për tarifën 2.1 % që i korresponon vlera: 204,871.4 lekë

Hapi i pestë: Llogaritja e tarifave për cdo fazë projektimi

Vlera e mesipërme 5201,308.3 lekë përfshin të 4 fazat e projektimit sipas shtojces 1, paragrafi 1.3.7.1 përkatësisht:

Nr.	Fazat e projektimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I- rë	Shërbimet këshilluese për gjeometrinë e ndërtesës	2% x 204,871.4= 4,097.428 lekë
2	Faza e II -të	Piketime për ekzekutim	14% x 204,871.4= 28,682 lekë

3	Faza e III -të	Matja e realizimit të punimeve	66% x 204,871.4= 135,215.1 lekë
4	Faza e IV -ërt	Mbikëqyrja e aspekteve topografike në zbatim	18% x 204,871.4= 36,876.85 lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për topografin do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura.

Shëmbull 2

Më poshtë po paraqesim një rast konkret se si duhet të llogarisim tarifat e planifikuesit urban për hartimin e Planit të Detajuar Vendor për zonën X në Bashkinë Y.

Hapi i parë: Përcaktimi i sipërfaqes në hektarë i zonës për të cilën do të hartohet PDV.

Sipërfaqja = 8 ha

Hapi i dytë: Përcaktimi i grupit tarifor

Për të gjetur grupin tarifor i referohemi nenit 21 si edhe shtojcës 5

Per të përcaktuar grupin tarifor na ndihmon sistemi i pikëzimit si me poshte:

- i) Kushtet topografike dhe situata gjeologjike; (1-5 pikë) ----**2 pikë**, Zona ka qënë subjekt ndërtimi më parë dhe egzistojnë studime të mëparëshme gjeologjike dhe rilevimet topografike, të cilat lehtësojnë punën e planifikuesit urban.
- ii) Kërkesat mjedisore dhe kërkesat ndaj strukturës urbane, mbrojtja ndaj monumenteve; (1-5 pikë) ---- **3 pikë** , Në zonë nuk ka objekte të trashëgimisë kulturore, ose monumente kulture, por pranë zonës në studim kalon një rrugë urbane kryesore me trafik të lartë, e cila ka nevojë për studim të thelluar në impaktin mjedisor.

iii) Përdorimi dhe dendësia; (1-5 pikë)--- **5 pikë** Zona ka dendësi të lartë banimi si dhe një miks përdorimesh edhe funksionesh, çka kërkon një studim të thelluar për harmonizimin e tyre.

iv) Shkalla e kërkuar e cilësisë për procesin e planifikim/projektimit; (1-5 pikë) ---**5 pikë**

v) Lidhja me infrastrukturen ekzistuese; (1-5 pikë) ---**2 pikë**. Zona ka infrastrukturë kryesore ekzistuese e cila ofron mundësi lidhjeje me nyjet e tjera.

vi) Mbrojtja e mjedisit dhe kushtet ekologjike. (1-5 pikë) --- **3 pikë**. Zona ka hapësira të lira të cilat mund të përdoren për gjelbërim, gjithashtu në zonë egziton edhe një hapësirë me biodiversitet të lartë, e cila kërkon zgjidhje për mbrojtjen e saj.

Ne fund do te llogarisim totalin e pikëve 20 pikë

Percaktojmë grupin tarifor si me poshte:

- | | |
|------------------------|---------------|
| 1) Grupi I Tarifor : | 0 - 10 pikë, |
| 2) Grupi II Tarifor : | 11 - 20 pikë, |
| 3) Grupi III Tarifor : | 21 - 30 pikë, |

Shërbimi i lidhur me Planifikimin e territorit për hartimin e Planit të Detajuar Vendor i perket grupit tarifor II

Hapi i tretë: Llogaritja e tarifave të proktimit për planifikuesin urban

Për llogaritjen e tarifës së projektimit për planifikuesin urban i referohemi Tabelës Nr.3 Planet e Detajuara Vendore(Neni 21)

Sipërfaqja në hektarë është 8 ha
Grupit tarifor II

Sic vihet re nga tabela tarifa për hartimin e Planit të Detajuar Vendor del 10,225,150 lekë (min) - 1,925,140 lekë (max)

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakort mes palëve , gjatë momëntit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jete mes kufijve minimalë (10,225,150 lekë) dhe maksimalë (1,925,140 lekë), supozojmë se u ra dakort për tarifën 1,475,145 lekë.

Hapi i katërt : Llogaritja e tarifave për cdo fazë projektimi

Vlera e mësipërme 1,475,145 përfshin të 6 fazat e projektimit sipas shtojcës 5 përkatësisht:

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I-rë	Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse	$2.5\% \times 1,475,145 = 36,878.6$ lekë
2	Faza e II-të	Përgatitja e analizës së thelluar	$30\% \times 1,475,145 = 442,543.5$ lekë
3	Faza e III-të	Hartimi i planit paraparak	$25\% \times 1,475,145 = 368,786.3$ lekë
4	Faza e IV-ërt	Hartimi i planit përfundimtar	$40\% \times 1,475,145 = 590,058$ lekë
5	Faza e V-të	Projekti përfundimtar për miratim	$2.5\% \times 1,475,145 = 36,878.63$ lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për planifikuesin urban do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura.

Shembull 3

Më poshtë po paraqesim një rast konkret se si duhet të llogarisim tarifat e projektimit të një plani të përgjithshëm vendor. Bashkia e marrë në studim, ndodhet në veri të Shqipërisë, ka një popullsi prej 7,600 banorësh dhe në territorin e saj gjendet një "zonë urbane" (qytet) me 5,600 banorë dhe 5 fshatra të shpërndarë në territor.

Hapi i parë: Përcaktimi i tarifave në bazë të kriterëve të mëposhtme:

1. Numri i Banorëve: $7600 \text{ banorë} * 10 \text{ njësi/banorë} = 76,000 \text{ njësi}$
2. Sipërfaqe tokë truall $30 \text{ ha} * 1800 \text{ njësi/hektarë} = 54,000$
3. Sipërfaqe jo truall $120 \text{ ha} * 35 \text{ njësi/hektarë} = 4,200$

Vlera = 134,200 Njësi

Per të përcaktuar grupin tarifor na ndihmon sistemi i pikëzimit si me poshte:

vii) Kushtet topografike dhe situata gjeologjike; (1-5 pikë) --- **4 pikë**, Bashkia shtrihet në zonë malore me reliev të thyer dhe të vështirë. Në zonë ka nevojë të kryhen studime të mëtejshme gjeologjike – topografike.

viii) Kërkesat mjedisore dhe kërkesat ndaj strukturës urbane, mbrojtja ndaj monumenteve; (1-5 pikë) --- **4 pikë**, Në zonë nuk ka objekte të trashëgimisë kulturore, ose monumente kulture, por pranë zonës në studim kalon një rrugë urbane kryesore me trafik të lartë, e cila ka nevojë për studim të thelluar në impaktin mjedisor, gjithashtu në zonë urbane kalon edhe një lumë, i cili është i ndotur prej saj.

ix) Përdorimi dhe dendësia; (1-5 pikë)--- **3 pikë** Zona ka dendësi të ulët banimi dhe ndërtimi.

x) Shkalla e kërkuar e cilësisë për procesin e planifikim/projektimit; (1-5 pikë) --- **5 pikë**

xi) Lidhja me infrastrukturen ekzistuese; (1-5 pikë) --- **4 pikë**. Zona ka mangësi në infrastrukturë kryesore ekzistuese Zonat rurale kanë nevojë për akses më të mirë.

xii) Mbrojtja e mjedisit dhe kushtet ekologjike. (1-5 pikë) --- **2 pikë**. Zona ka hapësira të lira të cilat mund të përdoren për gjelbërim, gjithashtu në zonë egziton edhe

një hapësirë me biodiversitet të lartë, e cila kërkon zgjidhje për mbrojtjen e saj. Zona nuk ka presione në hapësirat mjedisore dhe ekologjike

Në fund do të llogarisim totalin e pikëve 22 pikë

Përcaktojmë grupin tarifor si më poshtë:

- | | |
|------------------------|---------------|
| 1) Grupi I Tarifor : | 0 - 10 pikë, |
| 2) Grupi II Tarifor : | 11 - 20 pikë, |
| 3) Grupi III Tarifor : | 21 - 30 pikë, |
| 3) Grupi IV Tarifor : | 21 - 30 pikë, |
| 3) Grupi V Tarifor : | 21 - 30 pikë, |

Shërbimi i lidhur me Planifikimin e territorit për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor i përket grupit tarifor III

Hapi i tretë: Llogaritja e tarifave të proktimit për planifikuesin urban

Për llogaritjen e tarifës së projektimit për planifikuesin urban i referohemi *Tabelës Nr.2 Planet e Përgjithshme Vendore*(Neni 20)

Njësia e llogaritjes është 134 200 Njësi = X
Grupit tarifor III

Sic vihet re nga tabela vlera, 134 200 Njësi gjendet mes dy vlerave :

K1 = 100,000 njësi ku për grupin tarifor III tarifat shkojnë nga (1,993,740 lekë = a), në (2,192,820 lekë =b)

K2 = 150,000 njësi ku për grupin tarifor III tarifat shkojnë nga (2,625,980 Lekë =c) në (2,888,900 lekë = d)

Tarifa për hartimin e Planit të Detajuar Vendor do të llogaritet me interpolim mes dy vlerave duke u bazuar në nenin 13 dhe shtojcën 11

$$H1_{min} = a + 0 \times (b-a) = 1,993,740 + 0 \times (2,192,820 - 1,993,740) = 1,993,740$$

$$H2_{min} = c + 0 \times (d-c) = 2,625,980 + 0 \times (2,888,900 - 2,625,980) = 2,625,980$$

$$D1 = X - K1 = 134\,200 - 100,000 = 34,200$$

$$D2 = K2 - K1 = 150,000 - 100,000 = 50,000$$

$$D3_{min} = H2 - H1 = 2,625,980 - 1,993,740 = 632,240$$

$$H1_{\min} + \frac{D3_{\min} \times D1}{D2} = 1,993,740 + \frac{632,240 \times 34,200}{50,000} = 2,426,192 \text{ lekë}$$

$$H1_{\max} = a + 1 \times (b-a) = 1,993,740 + 1 \times (2,192,820 - 1,993,740) = 2,192,820$$

$$H2_{\max} = c + 1 \times (d-c) = 2,625,980 + 1 \times (2,888,900 - 2,625,980) = 2,888,900$$

$$D1 = X - K1 = 134,200 - 100,000 = 34,200$$

$$D2 = K2 - K1 = 150,000 - 100,000 = 50,000$$

$$D3_{\max} = H2 - H1 = 2,888,900 - 2,192,820 = 696,080$$

$$H1_{\max} + \frac{D3_{\max} \times D1}{D2} = 2,192,820 + \frac{696,080 \times 34,200}{50,000} = 2,668,938 \text{ lekë}$$

Për vlerën e saktë të tarifës bihet dakort mes palëve , gjatë momentit të nënshkrimit të kontratës, ku kjo vlerë do të jete më së kufijve minimale 2,426,192 lekë dhe maksimale 2,668,938 lekë, supozojmë se u ra dakort për tarifën 2,500,000 lekë

Hapi i pestë: Llogaritja e tarifave për cdo fazë projektimi

Vlera e mësipërme 2,500,000 lekë përfshin të 6 fazat e projektimit sipas nenit 18 dhe shtojcës 4 , përkatësisht:

Nr.	Fazat e shërbimit	Përshkrimi	Përqindja e tarifës në lidhje me vlerën totale
1	Faza e I	Hartimi i nismës për fillimin e PPV dhe miratimi në instancat përkatëse	5% x 2,500,000 = 125,000 lekë

2	Faza e II	Përgatitja e analizës së thelluar	$20\% \times 2,500,000 = 500,000$ lekë
3	Faza e III	Hartimi i planit paraprak	$30\% \times 2,500,000 = 750,000$ lekë
4	Faza e IV	Hartimi i planit përfundimtar	$25\% \times 2,500,000 = 625,000$ lekë
5	Faza e V	Hartimi i rregullores	$15\% \times 2,500,000 = 375,000$ lekë
6	Faza e VI	Projekti përfundimtar për miratim	$5\% \times 2,500,000 = 125,000$ lekë

Në momentin e lidhjes së kontratës ose porositen të gjitha fazat ose porositen pjesërisht, në këtë rast vlera totale e pagesës për planifikuesin urban do jetë e llogaritur si shumë e vlerave të fazave përkatëse të porositura.